


Raport hulumtues

KOSOVA NË FRONT ME PASOJAT E NDRYSHIMIT TË KLIMËS

Kapacitetet institucionale

Autorë:
Skender Perteshi
Andi Batusha



Pikat e shprehura dhe opinionet janë ato të autorit/autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur - Ballkani Perëndimor.

Autorë:

Skender Perteshi
Andi Batusha

Dizajnuar nga:

Brand Vision Shpk
Kontakti: +383 45 559 923
Email: brandvision.rks@gmail.com

Rreth institutit PREVENT

I themeluar në vitin 2024, Instituti për Siguri dhe Reziliencë - PREVENT synon një Kosovë ku siguria, stabiliteti dhe sundimi i ligjit ruhen përmes qasjeve inovative dhe bashkëpunuese. Duke promovuar reziliencën dhe gjithëpërfshirjen, PREVENT përpiqet të krijojë një shoqëri ku individët, komunitetet dhe institucionet punojnë së bashku për të trajtuar sfidat komplekse të sigurisë. Misioni i PREVENT është të ndërtojë komunitete të qëndrueshme duke ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse dhe ekspertizë në zhvillimin e politikave publike, avokim dhe zbatim të projekteve.

PREVENT fokusohet në fuqizimin e grupeve të marginalizuara, veçanërisht të rinjve, përmes hulumtimeve të bazuara në të dhëna, nismave për ndërtimin e kapaciteteve dhe ofrimin e ekspertizës duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe duke luftuar aktivisht ekstremizmin e dhunshëm.

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen sipas Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme, mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen e shkruar të botuesit. Shfrytëzimi komercial i materialeve të botuara nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT nuk lejohet pa lejen e shkruar.

Prishtinë, Mars 2025

Përmbledhje Ekzekutive



<u>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</u>	<u>1</u>	<u>5.2 Raporti i BE-së për Kosovën për vitin 2024</u>	<u>13</u>
<u>Gjetjet Kryesore</u>	<u>7</u>	<u>5.3 Përfshirja e Kosovës në mekanizma të mbrojtjes civile</u>	<u>14</u>
<u>HYRJE</u>	<u>2</u>	<u>5.4 Kosova dhe OKB-ja</u>	<u>15</u>
<u>1. NDRYSHIMET KLIMATIKE SI ÇËSHTJE E SIGURISË</u>	<u>3</u>	<u>6. INSTITUCIONET PËR REAGIM NDAJ KATASTROFAVE NATYRORE: SFIDAT DHE NEVOJAT</u>	<u>18</u>
<u>2. NGRITJA E VETËDIJËS INSTITUCIONALE DHE QYTETARE NDAJ NDRYSHIMEVE TË KLIMËS</u>	<u>4</u>	<u>6.1 Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe kapacitetet e reagimit ndaj katastrofave Natyrorë në Kosovë</u>	<u>20</u>
<u>3. LEGJISLACIONI DHE POLITIKAT VENDORE PËR TRAJTIMIN E NDRYSHIMEVE TË KLIMËS</u>	<u>5</u>	<u>6.2 Forca e Sigurisë e Kosovës dhe reagimi ndaj katastrofave natyrore</u>	<u>21</u>
<u>4. KËRCËNIMET DHE RREZIQET NGA NDRYSHIMET KLIMATIKE NË KOSOVË</u>	<u>7</u>	<u>6.3 Institucionet tjera</u>	<u>22</u>
<u>4.1 Rreziqet prezente në territorin e Republikës së Kosovës</u>	<u>7</u>	<u>6.4 Niveli lokal</u>	<u>22</u>
<u>4.1.2 Temperat ekstreme</u>	<u>8</u>	<u>6.4.1 Kapacitetet e Komunave për parandalimin dhe reagimin ndaj katastrofave</u>	<u>23</u>
<u>4.1.3 Përmbytjet dhe vërshimet</u>	<u>9</u>	<u>6.5 Bashkëpunimi me shoqërinë civile, komunitetin dhe grupet joformale të vullnetarëve</u>	<u>24</u>
<u>4.1.4 Shtrëngatat dhe stuhitë e fuqishme</u>	<u>9</u>	<u>REKOMANDIMET</u>	<u>26</u>
<u>5. KOSOVA DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE</u>	<u>11</u>	<u>ANNEX 1.</u>	<u>28</u>
<u>5.1 Sfidat dhe rruga drejt integritimit Evropian</u>	<u>11</u>		

Përmbledhje Ekzekutive



Ndryshimet klimatike paraqesin një sfidë urgjente dhe komplekse për Kosovën, duke ndikuar jo vetëm në mjedis, por edhe në sigurinë publike, sigurinë ushqimore dhe ujore, shëndetin publik, ekonominë dhe stabilitetin shoqëror. Rritja e shpeshtësisë së përmbytjeve, thatësirave, stuhive ekstreme dhe fenomeneve të tjera të lidhura me ndryshimet klimatike po vë në provë qëndrueshmërinë sociale dhe aftësinë e institucioneve për të parandaluar dhe reaguar në mënyrë efektive.

Ky raport hulumtues, i realizuar nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë – PREVENT dhe i financuar nga Fondacionet për Shoqëri të Hapura - Ballkani Perëndimor (OSF-WB), analizon kapacitetet e institucionale të Kosovës për të përballuar sfidat klimatike. Raporti vlerëson gatishmërinë e institucioneve qeveritare dhe atyre lokale për hartimin, zbatimin dhe koordinimin e politikave të reagimit ndaj fatkeqësive të lidhura me klimën. Analiza përfshin institucione kyçe si Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, Policia e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Forca e Sigurisë e Kosovës dhe komunat.

Gjetjet Kryesore

Kosova përballlet me mungesë serioze të kapaciteteve institucionale në menaxhimin e rreziqeve klimatike, sidomos në përgjigjen emergjente, koordinimin mes institucioneve qendrore dhe lokale, si dhe në burimet financiare dhe teknike.

Kosova është shumë e cënueshme ndaj përmbytjeve të shpeshta, thatësirave të zgjatura, krizës së ujit, zjarreve në pyje dhe temperaturave ekstreme, të cilat kërcënojnë sigurinë ushqimore, shëndetin publik dhe stabilitetin ekonomik.

Edhe pse Kosova ka miratuar strategji klimatike si Strategjia për Ndryshimet Klimatike (2019-2028) dhe Ligjin për Ndryshimet Klimatike (2024), zbatimi mbetet i dobët, pjesërisht për shkak të mekanizmave të dobët të monitorimit, buxhetimit adekuat dhe mungesës së koordinimit ndërinstitutional.

Sistemi i emergjencave në Kosovë është i brishtë; komunat nuk kanë përgatitje të mjaftueshme dhe mungesë të vlerësimeve të rrezikut.

Kosova është e kufizuar në marrjen e ndihmës nga organizatat/mekanizmat ndërkombëtare; Kosova nuk është pjesë e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së (UCPM) për shkak të kufizimeve politike, por ka marrëveshje bashkëpunimi me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut Kroacinë, Malin e Zi dhe shtete tjera për koordinimin në raste emergjente.

Mungesa e angazhimit të qytetarëve dhe programeve të vetëdijesimit kufizon aftësinë e Kosovës për të zhvilluar një strategji të qëndrueshme të reziliencës komunitare ndaj fatkeqësive klimatike.



Ndryshimet klimatike janë një ndër sfidat më urgjente dhe komplekse të kohës sonë, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë jo vetëm në mjedis, por edhe në sigurinë publike, sigurinë e ujit dhe ushqimit, shëndetin publik, ekonominë dhe stabilitetin shoqëror. Përmbytjet e shpeshta, thatësitat, stuhitë ekstreme dhe fenomene të tjera të lidhura me ndryshimet klimatike po vënë në provë jo vetëm qëndrueshmërinë e ekosistemeve, por edhe aftësinë e institucioneve për të parandaluar dhe për të reaguar në kohë ndaj pasojave të tyre.

Ndryshimet klimatike nuk janë më thjesht një çështje e mbrojtjes së mjedisit, por një sfidë madhore e sigurisë që ndikon në stabilitetin e shteteve dhe komuniteteve. Përkeqësimi i kushteve klimatike mund të përshkallëzojë konfliktet ekzistuese, të krijojë burime të reja tensioni dhe të rrisë pasigurinë për komunitetet e cënueshme. Vendet me burime të kufizuara natyrore dhe me infrastrukturë të dobët janë më të ekspozuara ndaj efekteve të krizës klimatike, gjë që mund të çojë në zhvendosje masive të popullsisë, rritje të pasigurisë ushqimore dhe përkeqësim të kushteve socio-ekonomike.

Kosova nuk është immune ndaj këtyre sfidave. Përkundrazi, për shkak të infrastrukturës së brishtë, mungesës të një vizioni të qartë si dhe kapaciteteve të kufizuara institucionale, vendi përballet me pasoja të rënda nga ndryshimet klimatike. Ky raport analizon ndikimin e krizës klimatike në Kosovë, kapacitetet institucionale për përballimin e sfidave klimatike dhe strategjitë për forcimin e qëndrueshmërisë institucionale dhe civile ndaj këtyre rreziqeve.

Disa nga kërcënimet kryesore që përballet shoqëria dhe institucionet në Kosovë përfshijnë përmbytjet e shpeshta, sidomos në rajonet veriore dhe perëndimore të vendit, të cilat së fundmi kanë shkaktuar dëme të mëdha në infrastrukturë, bujqësi dhe shtëpi banimi, duke sfiduar kështu kapacitetet e institucioneve për menaxhimin e emergjencave. Thatësitat po bëhen më të zakonshme, duke ndikuar në ofrimin e ujit të pijes, rendimentin e të mbjellave dhe duke rrezikuar sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik, ndërkohë që fermerët shpesh nuk kanë mbështetjen e duhur për të përballuar humbet ekonomike. Kriza e furnizimit me ujë në disa zona të Kosovës po përkeqësohet për shkak

të thatësirave, ndotjes së lumenjve dhe mungesës së investimeve të duhura në mirëmbajtjen dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe sistemit të trajtimit të ujërave të zeza. Këto janë disa nga sfidat madhore dhe rreziqet në rritje që vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike dhe që kërkojnë vëmendjen e duhur të institucioneve për t'u përballuar në mënyrë sa më efikase.

Në këtë kontekst, një sistem i qëndrueshëm i menaxhimit të rreziqeve klimatike kërkon kapacitete institucionale të përgatitura mirë, si në nivelin qëndror ashtu edhe në atë lokal. Këto kapacitete përfshijnë jo vetëm kuadrin ligjor, strategjik dhe politikat, por edhe burimet njerëzore, financiare dhe teknike që u mundësojnë institucioneve të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive, si dhe të përballen me rreziqet që vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike.

Ky raport synon të analizojë kapacitetet e institucioneve në Kosovë që janë përgjegjëse për parandalim dhe reagim ndaj pasojave të ndryshimeve klimatike. Institucionet kryesore që do të shqyrtohen përfshijnë kapacitetet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, Policisë së Kosovës, Ministrisë së Mbrojtjes, Forcës së Sigurisë së Kosovës, nivelin lokal të qeverisjes, si dhe institucioneve të tjera që kanë rol dhe përgjegjësi për adresimin e ndryshimeve klimatike apo përballjen me pasojat që këto ndryshime po sjellin.

Përmes një qasjeje empirike dhe analitike, raporti do të shqyrtojë sfidat kryesore me të cilat përballen këto institucione, duke përfshirë mungesën e burimeve financiare dhe njerëzore, koordinimin ndërinstitutional, kapacitetin teknik dhe zbatimin e politikave ekzistuese. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i analizës do të jetë vlerësimi i ndërveprimit mes niveleve të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe lokale) dhe akterëve të tjerë relevantë. Raporti ofron gjithashtu një pasqyrë të standardeve ndërkombëtare dhe obligimeve që burojnë nga aspiratat e Kosovës për t'u bërë pjesë e BE-së dhe OKB-së.

Në përfundim, raporti do të ofrojë rekomandime të cilat synojnë adresimin e boshllëqeve ekzistuese dhe përmirësimin e politikave dhe praktikave institucionale për një përgjigje më të efektshme dhe të qëndrueshme ndaj krizave klimatike.

1. Ndryshimet klimatike si çështje e sigurisë



Hulumtimet për ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre në çështjet e sigurisë janë ende të kufizuara, veçanërisht në fushën akademike, ku trajtimi i këtij fenomeni mbetet relativisht i pamjaftueshëm.¹ Bazuar në vlerësimet e kryera deri më tani, sidomos nga organizatat ndërkombëtare si NATO, theksohet se rajoni i Ballkanit Perëndimor po njihet gjithnjë e më shumë si një rajon i prekshëm ndaj rreziqeve klimatike.² Këto rreziqe përfshijnë rritjen e numrit të përmbytjeve, valët e të nxehtit, përhapjen e zjarreve, si dhe sfidat e burimeve ujore, të cilat mund të komplikojnë tensionet ekzistuese socio-politike dhe ato të sigurisë në rajon.

Vlerësimi i Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike dhe Sigurisë për vitin 2024³ thekson se ndryshimet klimatike nuk janë më vetëm një çështje mjedisore, por një sfidë komplekse që ndikon direkt në sigurinë ndërkombëtare. Në këtë kontekst, theksohet se ndryshimi i klimës jo vetëm që sjell rreziqe të reja, si katastrofat natyrore më të shpeshta dhe më të ashpra, por gjithashtu përkeqëson kërcënimet ekzistuese, duke përfshirë konfliktet mbi burimet natyrore, migrimin masiv dhe destabilizimin ekonomik në zona të ndjeshme, siç është Kosova dhe Ballkani. Këto dinamika kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese nga shtetet anëtare të NATO-s dhe partnerët ndërkombëtarë.

Në këtë raport theksohet se Kosova duhet të punojë ngushtë me partnerët e saj vendor dhe ndërkombëtarë, si NATO dhe organizatat të tjera ndërkombëtare përgjegjëse për çështjet e klimës, me qëllim adresimin

sa më mirë të sfidave të sigurisë që vijnë si rezultat i ndryshimeve të klimës. Pikërisht për këtë, NATO po integron ndryshimet klimatike në planet e saj strategjike të operimit dhe sigurisë, duke përfshirë operacionet ushtarake, në mënyrë që të jetë sa më efikase dhe e sigurtë në adresimin e sfidave të sigurisë që vijnë si rezultat i klimës.

Masat që NATO dhe shtetet e tjera të zhvilluara po ndërmarrin përfshijnë forcimin e infrastrukturës, zhvillimin e kapaciteteve për reagim të shpejtë, si dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për të adresuar këto kërcënime. Këto masa përfaqësojnë një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën se si NATO tani e koncepton sigurinë dhe qëndrueshmërinë në punën dhe operacionet e saj nëpër botë, duke siguruar që Aleanca të jetë e gatshme të përballët me sfidat e shekullit të 21-të. Nga kjo, ndryshimet klimatike nuk janë më thjesht një sfidë e së ardhmes, por një realitet i tanishëm që kërkon veprime të menjëhershme dhe të koordinuara.

Në linjë me rekomandimet e NATO-s dhe reformat e saj të sigurisë, duhet të reflektohen edhe masat që Kosova duhet të marrë për të adresuar sfidat e sigurisë që vijnë si rezultat i ndryshimeve të klimës. Pra, sfidat që vijnë nga ndryshimet e klimës duhet të integrohen mirë edhe në legjislationin e vendit, si dhe në politikat dhe strategjitë e sigurisë, duke përfshirë edhe politikat që adresojnë sfidat e sigurisë njerëzore dhe publike, me qëllim adresimin sa më mirë të ndikimit që klima po ka në jetën e përditshme të komunitetit. Për më shumë, rregullat dhe standardet e NATO-s për t'u përballur me sfidat e sigurisë që vijnë si rezultat i ndryshimeve të klimës, duhet të integrohen edhe në strukturën, punën dhe planet operationale të institucioneve të sigurisë së vendit, siç janë Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Agjencia për Menaxhim Emergjent (AME).

1 Barnett, J. (2014). Klima dhe siguria: dëshmi, rreziqe në zhvillim dhe një agjendë e re. *Climate Change*, e qasshme këtu: <https://link.springer.com/article/10.1007/s10584-014-1074-7>

Shih po ashtu: Rothe, D. (2021). Hulumtimi mbi ndryshimet klimatike dhe sigurinë: Konflikti, sigurizimi dhe veprimi. *PLOS Climate*; e qasshme këtu <https://journals.plos.org/climate/article?id=10.1371/journal.pclm.0000072>

2 NATO. (2024). Raporti i Vlerësimit të Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike dhe Sigurisë 2024. E qasshme këtu https://www.nato.int/nato_static_files2014/assets/pdf/2024/7/pdf/240709-Climate-Security-Impact.pdf

3 Po aty.

2. Ngritja e vetëdijës institucionale dhe qytetare ndaj ndryshimeve të klimës



Në Kosovë, qytetarët dhe institucionet publike si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror, shpesh nuk disponojnë me informacionet e duhura lidhur me klimën, sigurinë dhe pasojat e ndryshimeve klimatike. Ky informacion është i domosdoshëm, pasi nuk mund të merren masa efikase pa një kuptim të plotë të ndikimeve që ndryshimet klimatike mund të kenë mbi stabilitetin dhe sigurinë në vend. Po ashtu, qytetarët e Kosovës dhe të rajonit janë shpesh viktimë të lajmeve të rreme dhe keqinformimit. Sipas platformës për verifikimin e fakteve në Kosovë - Hibrid, çdo muaj zbulohen rreth 60 deri në 80 lajme me përmbajtje të pasaktë.⁴ Informacionet e pasakta si të tilla, shpesh krijojnë pasiguri të mëtejshme dhe mjegullira që e bëjnë më të vështirë kuptimin e pasojave të ndryshimeve klimatike dhe ndikimin e tyre në çështjet e sigurisë.

Në këtë kontekst, është e domosdoshme të forcohen mekanizmat e informimit dhe sensibilizimit mbi ndryshimet klimatike dhe ndikimin e mundshëm të tyre. Kjo do të mundësojë që qytetarët dhe institucionet të jenë më të përgatitur dhe të aftë të reagojnë ndaj sfidave që mund të dalin si pasojë e këtyre ndryshimeve. Për të adresuar në mënyrë

efektive ndikimet e ndryshimeve klimatike në Kosovë, është thelbësore të sensibilizohen qytetarët dhe institucionet, veçanërisht profesionistët që punojnë në sektorin publik. Një studim i publikuar në revistën Sustainability⁵ thekson se ndërgjegjësimi i gjerë publik për pasojat e ndryshimeve klimatike ka potencial të madh për të krijuar një momentum të fuqishëm, që mund të kontribuojë në zhvillimin e politikave dhe praktikave që adresojnë këto sfida.

Për të adresuar ndryshimet klimatike në mënyrë efektive, është e nevojshme të zhvillohen strategji gjithëpërfshirëse dhe shumëplanëshe. Kjo mund të realizohet përmes organizimit të fushatave edukative për rritjen e ndërgjegjësimit publik, trajnimeve për zyrtarët publikë mbi integrimin e masave të adaptimit në politikat e tyre dhe nxitjes së angazhimit të komunitetit në proceset e vendimarrjes. Agjencia Evropiane e Mjedisit dhe UNFCCC kanë ofruar udhërrëfyes praktikë mbi këto aspekte. Informimi dhe vetëdijësimi mbeten elementë kyç për optimizimin e kapaciteteve parandalues dhe reaguese ndaj ndryshimeve klimatike.

⁴ Bllaca, E. (2023, September 21). Hibrid: Në Kosovë, 60 deri në 80 lajme në muaj me përmbajtje keqinformuese. Zëri i Amerikës. E qasshme këtu <https://www.zeriamerikes.com/a/7278366.html>

⁵ Rahimi, M. (2020). Ndërgjegjësimi publik: Çfarë duhet të marrin parasysh shkencëtarët e ndryshimeve klimatike. Sustainability. E qasshme këtu <https://doi.org/10.3390/su12208369>

3. Legjislacioni dhe politikat vendore për trajtimin e ndryshimeve të klimës



Përballë sfidave globale të ndryshimeve klimatike dhe pasojave të tyre në nivel kombëtar, Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të integruar çështjet e mjedisit dhe sigurisë në politikën e saj zhvillimore. Megjithatë, ende ka nevojë për përmirësime në përshtatjen e kuadrit strategjik dhe legjislativ të vendit me synimet dhe standardet ndërkombëtare për çështjet e klimës, veçanërisht ato të përcaktuara nga BE. Ndër veprimet më të rëndësishme të ndërmarra nga Kosova për të adresuar këto sfida është krijimi i një arkitekture strategjike dhe legjislative për menaxhimin e pasojave të ndryshimeve klimatike, e cila gjithashtu lidhet me aspekte të rëndësishme të sigurisë kombëtare. Dokumenti kryesor që ka udhëhequr këtë proces është Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019-2028,⁶ e cila, së bashku me Planin e Veprimit të miratuar në vitin 2018 nga Qeveria e Republikës së Kosovës,⁷ paraqet kornizën për zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Zbatimi i Strategjisë për Ndryshimet Klimatike ka çuar në zhvillimin e ligjeve dhe planeve të veprimit specifike. Në veçanti, Ligji për Ndryshimet Klimatike⁸ është miratuar për të përcaktuar masat e Kosovës për zbutjen dhe adaptimin, duke siguruar përputhshmëri me marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme dhe duke lehtësuar tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët. Ky dokument është hartuar për të plotësuar poashtu edhe Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2022-2031⁹ duke krijuar një

qasje të unifikuar për zhvillimin e qëndrueshëm. Duke integruar shqetësimet klimatike në planifikimin e energjisë dhe përpjekjet për ruajtjen e mjedisit, Kosova synon të arrijë një rritje socio-ekonomike të balancuar dhe të qëndrueshme.¹⁰

Përveç Strategjisë për Ndryshimet Klimatike, janë miratuar edhe disa dokumente të tjera strategjike si Strategjia e Sigurisë e Kosovës 2022-2027¹¹ e cila përmban masa specifike për minimizimin e rreziqeve dhe forcimin e mekanizmave institucionale për menaxhimin e pasojave klimatike dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030¹² e cila përfshinë masa të ngjashme për të adresuar këto çështje e njëherit shërben si ombrellë e strategjive tjera sektoriale.

Një dokument veçanërisht i rëndësishëm për adresimin e rreziqeve që rrjedhin nga ndryshimet klimatike është Strategjia Shtetërore për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera 2023-2028¹³. Ky dokument synon zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në nivel vendi, duke planifikuar dhe zbatuar masa nga institucionet qendrore dhe lokale. Çështjet e menaxhimit të fatkeqësive janë gjithashtu të rregulluara në Planin e Reagimit Kombëtar¹⁴, i cili siguron një strukturë koordinuese për përballjen me incidente emergjente, si pandemitë, zjarret, vërshimet, dhe fenomene tjera ekstreme të ndikuara nga klima.

[ergjise-e-Republikes-se-Kosoves-2022-2031.pdf](#)

10 Po aty.

11 Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia e sigurisë së Kosovës. E qasshme këtu <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/1-Strategjia-e-Sigurise-e-Kosoves-ALB.pdf>

12 Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim 2030, mars 2030. E qasshme këtu <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/06032023-Strategjia-dhe-Plani-Kombetare-per-Zhvillim-2030.pdf>

13 Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia Shtetërore për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera 2023-2028, 2022,

14 Qeveria e Republikës së Kosovës, Plani i Reagimit Kombëtar, 2023. E qasshme këtu <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/EditorFiles/TextHtml/1118/Plani%20I%20Reagimit%20Komb%C3%AABtar%20I%20miratuar.pdf>

6 Gazeta zyrtare, Strategjia për ndryshimet klimatike 2019-2028 dhe plani i veprimit për ndryshime klimatike 2019-2021 (Qeveria e Republikës së Kosovës), 15 qershor 2020. E qasshme këtu: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29356>

7 Po aty

8 Gazeta zyrtare, Ligji nr.08/L-250 për ndryshimet klimatike, 5 janar 2024. E qasshme këtu <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85112>

9 Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031, marrë <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/Strategjia-e-Energjisë-e-Republikes-se-Kosoves-2022-2031.pdf>

Pavarësisht progresit të viteve të fundit Raporti i BE-së për Kosovën 2024 vëren se Kosova është ende në fazat fillestare të përafrimit me legjislacionin e BE-së (acquis) për mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Kapacitetet e institucioneve të mjedisit, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, mbeten jashtëzakonisht të kufizuara, duke penguar seriozisht përparimin në këtë sektor. Për më tepër, reformat strukturore vazhdojnë të vonohen për shkak të mungesës së angazhimit politik dhe financimit të pamjaftueshëm. Këto mangësi jo vetëm që e pengojnë zbatimin e ligjeve dhe strategjive të miratuara, por edhe krijojnë një mjedis ku degradimi mjedisor vazhdon pa ndëshkim efektiv e për rrjedhojë përkeqësim/përshkallëzim të efekteve negative në rast të vërshimeve, thatësirave, shtrëngatave e tjera fatkeqësi natyrore.

Përmirësimi më i madh në këtë fushë është miratimi i

Ligjit për Ndryshimet Klimatike në dhjetor 2023, por ai ende nuk ka një objektiv të qartë për neutralitetin e karbonit deri në vitin 2050. Po ashtu, Kosova duhet të miratojë sa më shpejt Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP) dhe të zbatojë mekanizmat e raportimit dhe verifikimit të gazrave serrë.¹⁵ Këto hapa janë thelbësorë për të siguruar harmonizimin me politikën e BE-së mbi klimën dhe për të hapur rrugën drejt mekanizmave të çmimit të karbonit, të cilët mund të ndihmojnë në dekarbonizimin e sektorit të energjisë në Kosovë. Megjithatë, zbatimi i masave të përshtatjes dhe zbutjes së ndikimit klimatik mbetet i pamjaftueshëm, ndërsa vetëdija publike për çështjet klimatike është ende e ulët.

¹⁵ Në kohën e shkrimit të këtij raporti, statusi i NECP ishte ende i qasshëm për konsultim publik, dhjetor 2024. E qasshme këtu <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42695>

4. Kërcënimet dhe Rreziqet nga Ndryshimet Klimatike në Kosovë

4.1 Rreziqet prezente në territorin e Republikës së Kosovës

Edhe pse relativisht e vogël në përmasa , Republika e Kosovës përqendrohet në shumë rreziqe natyrore për shkak të territorit të saj kryesisht malor dhe pranisë së dy fushave. Kosova është e ekspozuar ndaj disa rreziqeve gjeologjike dhe hidrometeorologjike, si përmbytjet, borat e shumta, thatësira, zjarret në pyje dhe tërmetet, të cilat ndikojnë në terrenin e ndryshëm të vendit. Zona malore preken nga përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut, ndërsa ndryshimet klimatike po

rrisin rrezikun nga zjarret, që janë bërë më të shpeshta, duke shqetësuar sidomos pyjet që mbulojnë 43% të territorit. Në vitin 2021, 92 zjarre shkrumbuan 7,580 ha tokë. Për të rritur qëndrueshmërinë, forca në vlerësimin e rrezikut dhe angazhimin e komunitetit janë të nevojshme.

Shumica e prodhimeve industrial dhe të sistemeve të ngrohjes funksionojnë me linjit /qymyr që gjeneron ndotje të konsiderueshme, si dhe burime të rreziqeve teknologjike, nga nxjerrja deri në përdorimin përfundimtare

Disa nga rreziqet që kërcenojnë Republikën e Kosovës janë:

RREZIQET NATY-RORE	RREZIQET NË NDËRTESAT TEKNIKE TË NDJESHME – INFRASTRUKTURA KRITIKE	RREZIQET GJATË TRANSPORTIT	RREZIQET IN-DUSTRIAL	RREZIQET EPIDE-MIOLOGJIKE
 Zjarret	 Dëmtimet e digave	 Transportit rrugore	 Energjia	 Helmimet me ujë
 Shtrengatat		 Transporti hekurudhor	 Aksidentet industrial	 Sëmundjet zonotike transmissive
 Vërshimet		 Transporti ajror	 Mbetjet industrial dhe te rrezikshme	
 Tërmetet		 Transporti me materiale te rrezikshme		
 Rrokullisjet, shembjet e masave shkëmbore				

TABELA 1: Rreziqet kryesore në Kosovë

4.1.2 Temperat ekstreme

Kosova ka përjetuar ndryshime të dukshme si pasojë e ndryshimeve klimatike, duke u përballur me temperatura ekstreme, reshje të dendura shiu dhe përmbytje të shpeshta. Krahasuar me vitet 1960, rajoni ka përjetuar një rritje të ndjeshme të valëve të të nxehtit, të cilat janë bërë më të shpeshta dhe më intensive, si dhe reshje të mëdha shiu që kanë shkaktuar përmbytjet më të gjera që nga vitet 1980. Po ashtu, zjarret në pyje janë rritur ndjeshëm që nga vitet 2000. Thatësira të mëdha janë regjistruar në vitet 1993, 2000, 2007, 2009, 2012, 2020 dhe 2022, duke ndikuar negativisht në furnizimin me ujë dhe sektorin bujqësor.¹⁶

Gjatë viteve të fundit, vendi ka regjistruar temperatura rekord të larta, të cilat kanë zgjatur për javë të tëra, duke ndikuar në shëndetin e qytetarëve, rritjen e kërkesës për ndihmë mjekësore dhe përhapjen e zjarreve. Përveç ndikimeve në shëndetin publik, valët e të nxehtit dhe thatësitat kanë shkaktuar reduktime në furnizimin me ujë, duke vështirësuar jetesën në zonat urbane dhe rurale. Ndikimi është ndjerë veçanërisht në sektorin bujqësor, ku prodhimi i ushqimeve bazë është dëmtuar ndjeshëm, duke rrezikuar sigurinë ushqimore dhe duke ndikuar në ekonominë rurale.

Temperaturat në rritje dhe menaxhimi i dobët i pyjeve kanë çuar gjithashtu në shtimin e zjarreve, duke dëmtuar ekosistemet dhe biodiversitetin e vendit. Kjo rritje e temperaturave ekstreme, si rezultat i ndryshimeve klimatike, ka rritur kërcënimet dhe rreziqet për sigurinë në vend, siç janë përhapja e zjarreve, ndikimi në prodhimin e ushqimit, reduktimi i ujit, si dhe ndikimi në problemet shëndetësore për qytetarët.

Për më tepër, një kujdes i vogël është kushtuar edhe mbrojtjes së resurseve ujore dhe menaxhimit të lumenjve në vend. Institucionet kanë investuar pak në menaxhimin e burimeve ujore, të cilat janë jetike për t'u përballur me periudhat e temperaturave ekstreme që pritet të mbizotërojnë në vend vitet në vijim. Rreziku

nga përhapja e zjarreve në zona fushore dhe malore, si rezultat i ndryshimeve klimatike dhe temperaturave ekstreme, është shumë i madh. Kjo është veçanërisht e vërtetë për shkak të faktit se një pjesë e madhe e territorit të Kosovës është zonë fushore dhe malore, ku mundësia për përhapjen e zjarreve është e madhe. Vitet e fundit janë shpeshtuar përhapjet e zjarreve në Kosovë, të cilat kanë zgjatur për ditë të tëra, duke mos pasur mundësi për t'u menaxhuar ose shuar nga ana e institucioneve vendore.

Gjatë vitit 2024 vendi është përballur me një seri zjarresh në vendet turistike, si malet e Sharrit, Prevallë, malet e Rrafshit të Dukagjinit, që ishin një sinjal se në të ardhmen vendi do të përballlet me raste të shpeshta zjarresh si rezultat i ndryshimeve klimatike dhe ngritjes së temperaturave ekstreme. Për rrezikun nga zjarret ka alarmuar edhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, e cila në vitin 2023, vuri në dukje se Kosova është bërë pjesë e vendeve me nivel ekstrem të rrezikut për zjarre pyjore. Kjo është vërtetuar gjithashtu nga rastet e mëdha të zjarrit që janë shfaqur në Kosovë sidomos gjatë tre viteve të fundit, ku vetëm në vitin 2024 pati deri në 100 raste zjarri, disa prej të cilave ishin shumë të mëdha dhe kërkuar intervenimin e KFOR-it nga ajri, si dhe kërkuar ndihmë nga FSK. Rritja e numrit të zjarreve në Kosovë, sidomos gjatë muajve të verës, sfidon institucionet e vendit për t'u përballur me to. Gjatë muajve të verës, situata me zjarre shpesh del jashtë kontrollit, dhe AME si institucion primar reagues, e ka pothuajse të pamundur të reagojë për të vendosur nën kontroll përhapjen e zjarreve.

Për këto ndryshime, shoqëria kosovare dhe institucionet shtetërore nuk janë përgatitur mjaftueshëm, përkundrazi kanë lejuar shkatërrimin e tokës bujqësore dhe pyjeve, burimeve ujore, të cilat janë mekanizma të rëndësishëm për t'u mbrojtur dhe për t'u përballur me zjarret dhe pasojat e tjera të ndryshimeve klimatike. Për vite me radhë, qeveritë e ndryshme të Kosovës, si dhe niveli lokal, nuk e kanë vendosur si prioritet përgatitjen e institucioneve dhe shoqërisë për tu përballur me ndryshimet klimatike, përfshirë temperaturat e larta. Për më tepër, nuk është kushtuar vëmendje mbrojtjes së ambientit, pyjeve, apo krijimit të hapësirave të gjelbra në zonat urbane, ku ndërtimi ka bërë pothuajse të pamundur zgjerimin e parqeve publike apo hapësirave të gjelbra në qytete. Si pasojë, është bërë pothuajse e pamundur të rriten hapësira

16 AMMK. (2022). Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Mjedisit në Kosovë 2022. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. E qasshme këtu: <https://www.ammk-rks.net/>

Shih poashtu: UNKT. (2023). Raporti Vjetor i Rezultateve 2023. Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë. E qasshme këtu: https://kosovoteam.un.org/sites/default/files/2024-04/UN_Annual%20Report%202023_Digital.pdf

të gjelbra në zonat urbane gjatë muajve të nxehtë të korrikut dhe gushtit.

4.1.3 Përmbytjet dhe vërshimet

Një nga rreziqet dhe pasojat e ndryshimeve klimatike me të cilat po përballlet Kosova dhe rajoni, janë reshjet e shpeshta dhe të rrufeshme, të cilat janë intensifikuar vitet e fundit.¹⁷ Reshjet e shpeshta dhe të fuqishme në Kosovë kanë çuar në përmbytje dhe vërshime të shpeshta, të cilat kanë shkaktuar dëme të mëdha në ekonominë familjare, në bujqësi, dhe madje kanë pasur pasojë fatale për jetën e qytetarëve. Në vitin 2023, si rezultat i vërshimeve në komunën e Pejës, humbën jetën dy qytetarë, një nënë dhe vajza e saj, të cilat vdiqën si pasojë e vërshimeve dhe përmbytjeve që ndodhën.¹⁸ Sipas vlerësimeve të ekspertëve të mbrojtjes civile dhe institucioneve të tjera të sigurisë, kjo ngjarje ndodhi për shkak të faktit që vendi ku ndodhën përmbytjet dhe shtëpia ku jetonin vajza dhe nëna e saj ishte shumë e rrezikshme dhe me potencial për t'u përmbytur. Mekanizmat lokalë që dhanë leje për ndërtimin e kësaj shtëpie nuk e morën parasysh rrezikun që mund t'i kanoset kësaj shtëpie si pasojë e përmbytjeve, si dhe nuk ndërmorën masat për të parandaluar këtë ndërtim në një vend të tillë. Ky shembull është tregues se gjatë procesit të ndërtimit duhet të vendosen kritere dhe standarde optimale për të adresuar sfidat e ardhshme që vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike. Për më shumë, kërkohet një inspektim dhe mbikëqyrje rigorozë e projekteve të ndërtimit të lartë dhe atyre infrastrukturale me qëllim për t'u përballur më mirë me sfidat si zjarret, përmbytjet dhe shtrëngatat.

Sfida më e madhe mbetet hartimi dhe zbatimi strikt i planeve zhvillimore komunale dhe atyre urbanistike, të cilat duhet të vendosin standarde dhe kritere të rrepta për sektorin e ndërtimit, për të adresuar edhe sfidat që dalin si pasojë e ndryshimeve klimatike. Moszbatimi i kritereve strikte për sektorin e ndërtimit në zonat urbane, si dhe mosndërtimi i infrastrukturës së duhur, ka bërë që ndërtimet në zonat urbane të mos zbatojnë

fare kritere, duke pamundësuar procedurat normale për shkarkimin e ujërave që vijnë si rezultat i reshjeve të shpejta. Mungesa e infrastrukturës së duhur ujore dhe sistemeve të ujërave të zeza ka shkaktuar vërshime dhe përmbytje të shpejta, veçanërisht në zonat urbane.

Një sfidë tjetër e madhe është shkatërrimi i lumenjve dhe mosmirëmbajtja e shtatit të lumenjve në rajone të ndryshme të Kosovës. Mungesa e investimeve dhe planeve të qeverisjes lokale dhe qendrore për ruajtjen e lumenjve dhe mirëmbajtjen e shtatit të tyre, është një tregues që adresimi i çështjeve të klimës, si dhe pasojave që vijnë nga ky fenomen, nuk është ndër prioritetet kryesore. Pra, përderisa nuk ka vullnet politik dhe institucional për adresimin e këtyre sfidave, qytetarët do të vazhdojnë të përballen me këto fenomene.

4.1.4 Shtrëngatat dhe stuhitë e fuqishme

Kosova po përballlet gjithnjë e më shpesh me shtrëngata dhe stuhi të fuqishme, të cilat janë intensifikuar së fundmi. Këto fenomene të motit ekstrem, të shoqëruara me erëra të fuqishme, reshje të dendura shiu, breshër dhe rrufe, kanë shkaktuar dëme të mëdha materiale dhe kanë rrezikuar jetën e qytetarëve. Përmbytjet e shpejta kanë prekur zona urbane dhe rurale, duke dëmtuar infrastrukturën, pronat private dhe bujqësinë, ndërsa erërat e forta kanë rrëzuar pemë, shtylla të energjisë elektrike dhe çati shtëpish, duke lënë mijëra familje pa furnizim me rrymë.

Strategjia kombëtare për zvogëlimin e katastrofave natyrore dhe katastrofave të tjera ka parashikuar një rritje të numrit të shtrëngatave, stuhive dhe shirave të rrufeshëm si pasojë e ndryshimeve klimatike.¹⁹ Përveç hartimit të planeve komunale dhe reagimit ndaj katastrofave natyrore, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ruajtjes së hapësirave të gjelbra, pyjeve, sistemit të ujërave të zeza dhe zbatimit të kritereve strikte për ndërtimin, veçanërisht për ndërtimet në lartësi në zonat urbane.

Breshëri ka dëmtuar rëndë sektorin bujqësor, duke shkatërruar të mbjellat dhe duke shkaktuar humbje të konsiderueshme për fermerët, ndërsa rrufetë kanë rritur rrezikun e zjarreve dhe kanë dëmtuar pajisje

17 Kosovo 2.0. (2023). Vërshimet ende e zënë Kosovën në befasi.

Marrë nga <https://kosovotwopointzero.com/vershimet-ende-e-zene-kosoven-ne-befasi/>

18 KOHA.net. (2024, 6 mars). Nënë e bir vdesin si pasojë e vërshimeve në Pejë, familjarët kritikojnë institucionet. Koha.net.

Marrë nga: <https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/nene-e-bir-vdesin-si-pasoj-e-vershimeve-ne-peje-familjaret-kritikojne-institucionet>

19 Qeveria e Republikës së Kosovës. (2023). Strategjia Shtetërore për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera 2023–2028.

elektrike dhe struktura publike. Në vitet e fundit, Kosova ka përjetuar disa stuhi të fuqishme me pasoja në ekonomi dhe jetë qytetarësh. Në vitin 2022 dhe 2023, disa rajone, përfshirë Prishtinën, Pejën, Vushtrinë, Gjakovën dhe Mitrovicën, u goditën nga shtrëngata të mëdha, të cilat sollën përmytje, dëmtime në infrastrukturë dhe ndërprerje të energjisë elektrike. Në korrik 2023, një stuhi e fuqishme në komunat në zonat e perëndimore të Kosovës shkaktoi dëme të mëdha në bujqësi për shkak të breshrit dhe rrufeve, ndërsa në vitin 2020, Prizreni u përball me një stuhi të ashpër që dëmtoi rrjetin elektrik dhe infrastrukturën publike. Në janar të vitit 2024, si rezultat i një stuhie, u shemb kulmi i objektit të komunës së Prishtinës, dhe një qytetare u lëndua rëndë. Këto janë vetëm disa nga rastet e shpeshta të stuhive dhe shtrëngatave të fuqishme me të cilat përballet vendi.²⁰

Lidhur me këtë është konstatuar se në shumicën e rasteve, ku si pasojë e shtrëngatave kemi pasoja të

dëmeve materiale apo rrezik për jetën e njerëzve, ato ndodhin për shkak të moszbatimit të kriterëve dhe standardeve të ndërtimit. Në rastin e shembjes së kulmit të komunës së Prishtinës në janar të vitit 2024, hetimet e prokurorisë dhe vlerësimet e komunës së Prishtinës, kanë vërtetuar se shembja e kulmit të ndërtuar nga një operator privat ka ardhur si pasojë e moszbatimit të kriterëve të ndërtimit gjatë procesit të ndërtimit të kulmit të këtij objekti.²¹ Po ashtu, është vërtetuar se menaxheri i kontratës, një zyrtar nga komuna e Prishtinës, me qëllim përfitimin personal, ka lejuar shmangie nga kriteret e kontratës për ndërtimin e kulmit, duke rezultuar në një ndërtim të dobët dhe punë të paqëndrueshme. Si pasojë e kësaj, një stuhi që u vlerësua si jo e fortë nga ana e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, shkaktoi shembjen e kulmit të objektit të komunës dhe lëndimin e një qytetari të komunës së Prishtinës.

20 KALLXO.com. (2024, 7 mars). Çka ndodhi me kulmin e objektit të ri të Komunës së Prishtinës? Marrë nga: <https://kallxo.com/komuna/cka-ndodhi-me-kulmin-e-objektit-te-ri-te-komunes-se-prishtines/>

21 Radio Evropa e Lirë. (2024, 7 mars). Arrestim pas rrëzimit të kulmit të objektit të ri të Komunës së Prishtinës. Marrë nga: <https://www.evropaelire.org/a/arrestim-renia-e-kulmit-komuna-prishtine-/32787110.html>

5. Kosova dhe standardet ndërkombëtare



Më 2003, shtetet anëtare të BE-së në Samitin e Selanikut njëzëri afirmuan prespektivën për integrim në BE të shteteve të Ballkanit Perëndimor duke përfshirë edhe Kosovën²². Që nga ajo kohë, orientimi strategjik i Kosovës është bazuar në përafrimin e legjislacionit, standardeve dhe praktikave me ato të BE-së. Formalizimi konkret i këtij rrugëtimi u bë i mundur vetëm në vitin 2015²³ pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA)²⁴ mes Kosovës dhe BE-së. Që nga kjo kohë, Kosova ka formalizuar kornizën e reformave që duhet t'i ndërmarrë duke përfshirë edhe ato në fushën e klimës e për rrjedhojë ato të mbrojtjes civile. Gjegjësisht, Kosova ka hartuar Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) i cili qartëson detyrat dhe përgjegjësitë për nivelin lokal dhe atë qendror.²⁵

Paralel me ndërmarrjen e reformave që burojnë nga integrimi evropian, Kosova vazhdon të bëjë përpjekje për t'u bërë anëtare e plotë e OKB-së, agjencive të saja të specializuara si dhe mekanizmave tjerë multilateralë. Në këtë drejtim Kosova ka harmonizuar qasjen e saj strategjike, sektoriale dhe atë legjislative në përputhje me politikat dhe vendimet që burojnë nga të qenurit anëtarë i OKB-së.

Ky rrugëtim i Kosovës me institucione relativisht të reja është përcjellë dhe vazhdon të përcillet me sfida të nduarndurshme. Pavarësisht kësaj, nuk mungon vullneti institucional që këto sfida të adresohen.

22 Komisioni Evropian. (2012, 20 dhjetor). Komisioni miraton planet e ristrukturimit të bankave spanjolle Liberbank, Caja3, Banco Mare Nostrum dhe Banco CEISS. Marrë nga https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/press_03_163

23 Çollaku, P. (2015, 27 tetor). Kosova nënshkruan marrëveshjen SAA me BE-në. Balkan Insight. Marrë nga [https://balkaninsight.com/2015/10/27/kosovo-signed-saa-with-eu-10-27-2015/​::contentReference\[oaicite:0|index=0\]](https://balkaninsight.com/2015/10/27/kosovo-signed-saa-with-eu-10-27-2015/​::contentReference[oaicite:0|index=0]) Shiko gjithashtu: Këshilli i Bashkimit Evropian. (2015, 27 tetor). Kosova nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në. Marrë nga <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-eu-stabilisation-association-agreement/>

24 Bashkimi Evropian dhe Komuniteti i Energjisë Atomike Evropiane. (2016, 16 mars). Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 71/3. Marrë nga <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A22016A0316%2801%29>

25 Qeveria e Republikës së Kosovës. (2022, 9 mars). *Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, 2022–2026*. Marrë nga <https://gzkrks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=55415>

5.1 Sfidat dhe rruga drejt integritimit Evropian

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) shërben si kornizë për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian (BE) ku përcaktohen hapat që vendi duhet të ndërmarrë për të avancuar drejt anëtarësimit. Më saktë, përmes neneve 115, 116 dhe 117 nën *titullin VIII mbi Politikën e Bashkëpunimit*, nga MSA-ja kërkohej që Kosova të zbatojë standardet evropiane në fushën e mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të emergjencave dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike. Për më tepër, kapitulli 30 i *Acquis Communautaire* mbi *Marrëdhëniet e Jashtme (gjerësisht i shtjelluar tek PKZMSA-ja)* nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe integritetit në mekanizmat e ndihmës civile të BE-së.

Për Kosovën dhe shtetet tjera që synojnë anëtarësimin në BE, fondet e Instrumentit të para-anëtarësimit (IPA) janë thelbësore në zbatimin e MSA-së dhe zhvillimin e kapaciteteve. Në një kuadër më të gjerë, këto fonde janë krijuar për të mbështetur shtetet që aspirojnë anëtarësimin në BE në përmbytjen e reformave politike, ekonomike dhe institucionale, duke i ndihmuar të harmonizojnë politikat dhe legjislacionin e tyre me standardet evropiane. Një shembull konkret i mbështetjes së IPA është programi “IPA Floods and Fires” (IPAFF)²⁶, i cili synon të përmirësojë kapacitetet e mbrojtjes civile në Kosovë dhe rajon për t'u përballur me përmbytjet dhe zjarret pyjore. Përmes IPAFF, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave në Kosovë (AME) ka përfituar nga trajnimet, pajisje dhe shkëmbime të praktikave më të mira, duke rritur kështu aftësinë e vendit për të menaxhuar dhe parandaluar fatkeqësitë natyrore.

Një tjetër dokument me rëndësi për Kosovën është Agjenda e Reformave Evropiane II (ERA II) e cila prioritetizon përafrimin e politikave të Kosovës me Bashkimin Evropian, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA). Ndër prioritetet e saj kryesore është forcimi i kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë klimatike. ERA II synon zhvillimin e strategjive për zvogëlimin e ndotjes, përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe

26 Shih faqen e projektit IPAFF në <https://www.ipaff.eu/>

rritjen e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, përfshin masa për gatishmërinë ndaj përmbytjeve dhe zjarreve, duke përmirësuar kapacitetet e institucioneve për menaxhimin e emergjencave dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive natyrore në mënyrë më efikase.

Përpjekjet e Kosovës për të përmirësuar kapacitetet institucionale dhe gatishmërinë për të përballuar ndryshimet klimatike mbështeten në mënyrë strategjike edhe nga Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) dhe Plani i Rritjes.²⁷ WBIF fokusohet në ofrimin e mbështetjes financiare direkte për projekte kyçe të infrastrukturës që synojnë lehtësimin e ndryshimeve klimatike dhe promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore.²⁸ Këto projekte janë të lidhura me agjendën e integritimit në BE dhe shërbejnë si mjete thelbësore për të adresuar cenueshmërinë e rajonit ndaj sfidave mjedisore. Për dallim nga WBIF, Plani i Rritjes ofron një qasje më gjithëpërfshirëse duke theksuar reforma të gjera ekonomike dhe institucionale që synojnë forcimin e kapacitetit të vendit për të menaxhuar zhvillimin në sektorë të ndryshëm, përfshirë çështjet mjedisore. Përderisa WBIF ndihmon Kosovën të sigurojë fonde për projekte që fokusohen në klimën, Plani i Rritjes mbështet kuadrin më të gjerë institucional të nevojshëm për zbatimin efektiv të tyre. Këto dy dokumente, së bashku, krijojnë një kuadër komplementar që mundëson Kosovës për të qenë më e përgatitur dhe për të adresuar ndryshimet klimatike, duke siguruar që burimet financiare dhe institucionale të mobilizohen në mënyrë efektive.

Ndonëse informata më të detajuara dhe i përditësuar në lidhje me përkrahjen e gjithmbarshme të donatorëve për realizimin e PKZMA-së, SKZH-së dhe strategjive

27 Komisioni Evropian. (2023, 8 nëntor). Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Marrë nga https://enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/growth-plan-western-balkans_en

28 Shënim: Dy shembuj projekte të financuara përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) që lidhen me ndryshimet klimatike dhe qëndrueshmërinë mjedisore në Kosovë:

Projekti për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë Erëmjedore në Kosovë (KEEERE): Ky projekt fokusohet në përmirësimin e efikasitetit të energjisë në sektorin publik dhe promovimin e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë. Ai mbështet përpjekjet e qeverisë për të reduktuar emetimet e gazeve serë, për t'u pajtuar me politikat e energjisë të BE-së dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë e përgjithshme të energjisë në Kosovë.

Projekti për trajtimin e ujërave të ndotura dhe mbrojtjen e mjedisit: Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e infrastrukturës së trajtimit të ujërave të ndotura në Kosovë, veçanërisht në zona urbane. Duke përmirësuar objektet e trajtimit të ujërave të ndotura, projekti kontribuon në cilësinë më të mirë të ujit, shëndetin publik dhe mbrojtjen e mjedisit, duke adresuar sfidat që sjellin ndryshimet klimatike dhe urbanizimi.

tjera sektoriale mungon, ajo cka duhet të theksohet se Kosova ka nevojë të rrisë investimet për të adresuar nevojat institucionale në raport me zvogëlimin e ndikimit të klimës. Në terma monetar, raporti i Bankës Botërore për Kosovën për vitin 2024²⁹ thekson nevojën për investime të konsiderueshme – të vlerësuara në 2.8 miliardë dollarë gjatë dekadës së ardhshme – për të zbutur ndikimet e përshkallëzuara klimatike që do ta godasin vendin në 10 deri në 15 vitet e ardhshme. Sipas këtij raporti, investimet duhet të orientohen në fushat që janë më të rrezikuara dhe të cenueshme si rezultat i ndryshimeve të klimës, si burimet e ujit, adresimi i përmbytjeve potenciale dhe zjarreve, si dhe ngritja e kapaciteteve institucionale dhe reziliencës shoqërore për t'u përballur me këtë fenomen.

Një tjetër kornizë obliguese masash dhe reformash për Kosovën është edhe Marrëveshja e Gjelbër e BE-së e cila paraqet njëkohësisht mundësi dhe sfidë për Kosovën, pasi kërkon një tranzicion të shpejtë nga qymyri, i cili ende mbetet burimi kryesor i energjisë në vend. Marrëveshja e Gjelbër e BE-së synon jo vetëm reduktimin e emetimeve dhe tranzicionin energjetik, por edhe përmirësimin e kapaciteteve të vendeve për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore, të cilat do të intensifikohen për shkak të ndryshimeve klimatike. Për Kosovën, kjo do të thotë investime në infrastrukturë rezistente ndaj klimës, përmirësim të sistemeve të menaxhimit të ujit, dhe forcim të mekanizmave të mbrojtjes civile dhe emergjencave.

Kritikët argumentojnë se BE-ja nuk ka siguruar ende mbështetje të mjaftueshme financiare për të ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor të përballojnë këtë ndryshim, duke i vendosur ato në një pozitë të pafavorshme konkurruese. Në të njëjtën kohë, disa aktorë politikë në Kosovë e shohin këtë si një tjetër barrë e vendosur nga BE-ja, duke kërkuar qasje më fleksibile dhe periudha më të gjata tranzicioni. Megjithatë, përfshirja në Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor mbetet e domosdoshme për të avancuar procesin e integritimit në BE dhe për të siguruar akses në fondet e BE-së për energjinë e pastër dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

29 Banka Botërore, Kosova – Raporti i Klimës dhe Zhvillimit të Vëndit, 9 dhjetor 2024. Marrë nga: <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/publication/kosovo-country-climate-and-development-report#:~:text=The%20report%20concludes%20that%20Kosovo,escalating%20impacts%20of%20climate%20change>.

5.2 Raporti i BE-së për Kosovën për vitin 2024

Në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën të vitit 2024³⁰, janë identifikuar disa sfida të ngjashme me ato të vitit 2023 në lidhje me planifikimin dhe reagimin ndaj pasojave të ndryshimeve klimatike. Megjithatë, raporti i vitit 2024 thekson përparime në disa aspekte dhe identifikon nevojën për përmirësime të mëtejshme. Ndër të tjera, në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën të vitit 2024, identifikohen disa sfida të rëndësishme që lidhen me kapacitetet e vendit për të menaxhuar ndryshimet klimatike dhe pasojat e fatkeqësive natyrore. Një prej mangësive kryesore është mungesa e një vlerësimi kombëtar të rrezikut që përputhet me standardet e BE-së. Ky vlerësim është i domosdoshëm për të identifikuar dhe adresuar rreziqet që mund të lindin nga ndryshimet klimatike dhe fatkeqësitë natyrore. Pa një vlerësim të tillë, Kosova nuk ka një pasqyrë të qartë të rreziqeve potenciale dhe mundësive për t'u përgatitur për to.

Përveç kësaj, raporti thekson se kapacitetet për reagim ndaj fatkeqësive natyrore mbeten të kufizuara. Edhe pse janë ndërmarrë disa përpjekje për të përmirësuar këto kapacitetet, mbetet ende një hendek në menaxhimin e situatave emergjente, veçanërisht në lidhje me përmbytjet, zjarret dhe ndotjen e ujërave. Kosova ende nuk ka një sistem të mirëpërcaktuar dhe të testuar për të reaguar shpejt dhe me efikasitet ndaj këtyre fatkeqësive, çka e bën vendin më të prekshëm ndaj dëmeve të mundshme.

Një tjetër mangësi thelbësore është mungesa e strategjive të detajuara për rikuperimin pas fatkeqësive, si dhe planifikimi i pamjaftueshëm i reagimit emergjent. Kjo do të thotë se pas një ngjarjeje të madhe fatkeqësie, Kosova mund të hasë vështirësi në organizimin e një rikuperimi efikas, duke i shtuar më shumë pasojat sociale dhe ekonomike. Pa strategji dhe plane të qarta dhe të miratuara për reagimin emergjent, e gjithë infrastruktura për menaxhimin e fatkeqësive mbetet në një nivel të paorganizuar, duke rritur rrezikun për pasiguri dhe kaos.

Raporti gjithashtu thekson nevojën për përmirësimin e koordinimit midis qeverisë qendrore dhe nivelit lokal në menaxhimin e emergjencave. Mungesa e një koordinimi efektiv mund të pengojë reagimin e shpejtë

dhe të koordinuar ndaj fatkeqësive, duke krijuar vonesa në ndërhyrje dhe duke rritur rrezikun për humbje jetësore dhe materiale. Për të garantuar një menaxhim efikas, është thelbësore që nivelet qendrore dhe lokale të punojnë së bashku për të siguruar një reagim të koordinuar dhe të shpejtë.³¹

Një tjetër problem i rëndësishëm është mospërdorimi i sistemit të komunikimit emergjent të përbashkët të Bashkimit Evropian (CECIS). Kosova ende nuk ka arritur të integrojë plotësisht këtë sistem, i cili është një mjet i rëndësishëm për koordinimin ndërkombëtar të reagimit ndaj emergjencave. Kjo kufizon mundësinë e Kosovës për të marrë ndihmë të shpejtë dhe të efektshme nga partnerët ndërkombëtarë gjatë situatave të krizës, duke penguar aftësinë për t'u reaguar në mënyrë të duhur. Gjithsesi, shembuj të përdorimit efektiv të komunikimit për ndihmë mund të vërehen përgjatë pandemisë (COVID-19) kur Kosova duke shfrytëzuar Qendrën e Koordinimit të Reagimit për Emergjencë (ERCC) - e cila është shtylla funksionale e UCPM-it, morri ndihmë nga Sllovenia (kryesisht me pako bazike dhe maska për mborjtje).³²

Ajo cka parashihet edhe përmes masave afatmesme në PKZMSA në sektorin e mbrojtjes civile është zhvillimi i sistemit të njoftimit të hershëm apo paralajmërimit të publikut (Public warning system) i cili aktualisht mungon³³. Ky sistem është paraparë të zhvillohet këtë vit (2025) përmes procesit të prokurimit publik, që kështu, AME qëndron një hap më afër standardizimit për përballje me fatkeqësitë natyrore dhe jo vetëm.

Këto sfida përbëjnë një pengesë të rëndësishme për përparimin e Kosovës në menaxhimin e ndryshimeve klimatike dhe pasojave të fatkeqësive natyrore. Raporti thekson se, për të adresuar këto mangësi, është e nevojshme të ndërmerren hapa të shpejtë dhe të koordinuar për të përmirësuar kapacitetet institucionale, për të hartuar strategji më të qarta dhe për të përforcuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Raporti identifikon poashtu disa përparime të rëndësishme që lidhen me menaxhimin e emergjencave dhe përgatitjen e vendit për pasojat e ndryshimeve

31 Intervistë me zyrtarë të AME-së, Dhjetor 2024.

32 Komisioni Evropian. (2021, 9 shtator). Sllovenia ndihmon vendet e Ballkanit Perëndimor për të përballuar emergjencën COVID-19. Marrë nga https://civil-protection-humanitarian-aid.ec.europa.eu/resources-campaigns/campaigns/emergency-preparedness/slovenia-helps-balkan-countries-face-covid-19-emergency_en

33 Nga intervistat e zhvilluara me zyrtarë nga MPB, Dhjetor 2024.

30 Komisioni Evropian. (2024, 30 tetor). Raporti për Kosovën 2024. Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit. Marrë nga https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en

klimatike. Një prej arritjeve kryesore është përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për menaxhimin e emergjencave. Raporti vlerëson përpjekjet për të krijuar një sistem më të strukturuar dhe të koordinuar për reagimin ndaj fatkeqësive natyrore, duke mundësuar një reagim më të shpejtë dhe më efektiv. Ky përmirësim ka krijuar mundësi për forcimin e bashkëpunimit midis institucioneve qendrore dhe lokale, si dhe ka mundësuar një menaxhim më të mirë të krizave në nivele të ndryshme.

Një tjetër përparim i rëndësishëm është rritja e ndërgjegjësimit dhe ofrimi i trajnimeve për menaxhimin e fatkeqësive. Raporti thekson se janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përmirësuar aftësitë e akterëve të përfshirë në menaxhimin e fatkeqësive, duke ofruar trajnime të dedikuara për menaxherët e emergjencave dhe punonjësit e qeverisjes lokale. Ky rritje e kapaciteteve për reagim ka kontribuar në përmirësimin e përgjigjes ndaj fatkeqësive, veçanërisht në nivelin lokal, ku ka një ndjeshmëri më të madhe ndaj këtyre çështjeve.

5.3 Përfshirja e Kosovës në mekanizma të mbrojtjes civile

Kosova nuk është pjesë e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së (UCPM) për shkak të sfidave politike, teknike dhe ligjore të lidhura me mosnjohjen e pavarësisë së saj nga pesë shtete anëtare të BE-së. Për t'u pranuar në këtë mekanizëm, kërkohet unanimiteti i të gjitha vendeve anëtare, gjë që aktualisht përbën pengesë për Kosovën. UCPM është një strukturë e BE-së që koordinon ndihmën ndërkombëtare për fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat, duke ofruar qasje në burime logjistike, teknike dhe financiare për parandalimin, gatishmërinë dhe reagimin ndaj katastrofave.³⁴ Nëse Kosova do të ishte pjesë e UCPM, ajo do të përfitonte:

- **Ndihmë të shpejtë nga BE-ja në raste fatkeqësish natyrore;**
- **Fonde për përmirësimin e infrastrukturës emergjente;**
- **Pjesëmarrje në trajnime dhe shkëmbime ekspertize me vendet e BE-së.**

Megjithatë, BE-ja ka ndërmarrë hapa për të forcuar kapacitetet e mbrojtjes civile të Kosovës. Në vitin 2024, Komisioni Evropian, në bashkëpunim me Bankën Botërore, lancoi një instrument të ri financiar me një financim fillestar prej 6 milionë eurosh.³⁵ Ky fond synon të ndihmojë autoritetet e mbrojtjes civile të vendeve anëtare të BE-së, shteteve pjesëmarrëse në UCPM, si dhe Gjeorgjisë dhe Kosovës, për të përmirësuar kapacitetet e tyre në arritjen e Objektivave të Qëndrueshmërisë ndaj Fatkeqësive.

Kosova, megjithëse nuk është pjesë e UCPM, merrë pjesë aktivisht në mekanizma rajonale të mbrojtjes civile si Korniza e Bashkëpunimit të Mbrojtjes Civile të Ballkanit Perëndimor. Këto platforma alternative mundësojnë shkëmbimin e njohurive, burimeve dhe koordinimin e reagimeve emergjente me vendet fqinje, me mekanizmat rajonalë dhe bashkëpunimin bilateral. Kosova ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me disa vende të rajonit për ndihmë të ndërnjësrelltë në raste emergjencash si Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, duke rritur kapacitetin e reagimit ndaj fatkeqësive natyrore dhe krizave humanitare. Këto mekanizma ndihmojnë Kosovën të kompensojë mungesën e pjesëmarrjes në UCPM dhe të rrisë bashkëpunimin për ndihmën emergjente rajonale. Institucionet si AME punojnë ngushtë me homologët e tyre në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut për koordinim të operacioneve emergjente, zhvillimin e planeve të përbashkëta të përgatitjes dhe shkëmbimin e informacionit teknik mbi parandalimin dhe menaxhimin e krizave.³⁶

Megjithatë, sfidat mbeten në aspektin e harmonizimit të procedurave dhe ndërtimit të një sistemi të centralizuar të menaxhimit të emergjencave që të përputhet me standardet e BE-së, një kërkesë e rëndësishme për integrimin e ardhshëm të vendit në strukturat evropiane të mbrojtjes civile. BE-ja rekomandon përmirësimin e kornizës ligjore, qeverisëse dhe financiare për përgatitjen ndaj fatkeqësive, si dhe zhvillimin e një plani të investimeve përgatitore. Po ashtu, Kosova duhet të përmirësojë koordinimin ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal dhe të nisë procesin e instalimit të sistemit të komunikimit emergjent të përbashkët të BE-së (CECIS).³⁷

³⁴ Komisioni Evropian, (n.d.). Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së. Marrë nga https://civil-protection-humanitarian-aid.ec.europa.eu/what/civil-protection/eu-civil-protection-mechanism_en

³⁵ Komisioni Evropian, Njoftim për shtyp, 29 Shkurt 2024, Marrë nga https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_24_1184

³⁶ Intervistë me përfaqësues nga AME, Prishtinë, 11.12.2024

³⁷ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën; po aty.

5.4 Kosova dhe OKB-ja

Mungesa e të qënurit shtet anëtar i BE-së, i OKB-së dhe organizatave tjera rajonale, e ka vendosur Kosovën në një pozitë të pafavorshme në raport me përfitimet që burojnë nga anëtarësimi. Anëtarësimi në OKB do t'i ofronte Kosovës mundësinë për të marrë pjesë në marrëveshjet dhe mekanizmat ndërkombëtarë të ndryshëm që lidhen me ndryshimet klimatike, duke përfshirë Marrëveshjen e Parisit dhe Konventën e OKB për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), të cilat ofrojnë një platformë për të diskutuar dhe zbatuar politikat e ndryshimeve klimatike.

Pavarësisht mungesës së anëtarësimit në OKB, Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të adresuar sfidat e ndryshimeve klimatike dhe për të integruar politikat mjedisore në zhvillimin e saj kombëtar. Kjo qasje përfshin adoptimin e politikave ndërkombëtare, bashkëpunimin rajonal dhe avansimin e legjislacionit vendor.

Në mungesë të statusit zyrtar si anëtare e OKB-së, Kosova ka zgjedhur të miratojë njëanshëm Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke përfshirë një fokus të veçantë në Objektivin e Zhvillimit të

Qëndrueshëm (SDG) nr.13 “Veprimi për Klimën.” Kjo strategji i mundëson Kosovës të ndërtojë politika kombëtare që synojnë uljen e emisioneve të gazrave serrë dhe promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë. Përmes kësaj qasjeje, Kosova jo vetëm që përafron politikat e saj me ato ndërkombëtare, por gjithashtu fiton besueshmëri në arenën globale.

Megjithëse Kosova nuk është anëtare e OKB-së, agjencitë e saja si Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), vazhdojnë të ofrojnë ndihmë përmes mekanizmave të ndryshëm. Shembulli më i fundit është Plani Emergjent i Rimëkëmbjes pas Përmytjeve nga FAO, i cili ofroi kupona për furnizime bujqësore për fermerët e prekur nga përmytjet. Ky projekt, i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), u realizua përmes Ekipit të OKB-së në Kosovë.³⁸ Ky shembull tregon se, pavarësisht sfidave politike, Kosova mund të marrë ende ndihmë ndërkombëtare në fusha kritike si rimëkëmbja nga fatkeqësitë natyrore.

38 Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Plani i rimëkëmbjes emergjente të FAO-s pas përmytjeve ofron një ndihmë për fermerët më të cenueshëm, 13 shtator 2023, <https://kosovoteam.un.org/en/245772-fao-post-flood-emergency-recovery-plan-offers-helping-hand-most-vulnerable-farmers>

PËRFITIMET E KOSOVËS NGA ANËTARËSIMI NË OKB		
QASJE NË MARRËVESHJE DHE STANDARDE NDËRKOMBËTARE	FINANCIM DHE MBËSHTETJET TEKNIKE:	PËRFORCIMI I LEGJITIMITETIT DHE ANGAZHIMI GLOBAL
Anëtarësimi në OKB do t'i mundësonte Kosovës të merrte pjesë plotësisht në diskutimet dhe negociatat ndërkombëtare mbi ndryshimet klimatike. Pjesëmarrja në marrëveshjen e Parisit, si dhe mundësia për të kontribuar në propozimin e politikave globale për uljen e emisioneve të gazrave serrë, do t'i ofronte Kosovës mundësinë të arrijë standarde të reja dhe të ndihmohet nga vendet më të avancuara në këtë fushë.	Si anëtare e OKB, Kosova mund të kishte qasje më të lehtë në mekanizmat ndërkombëtarë të financimit, si Fondi i Gjellbër i Klimës (GCF) dhe Fondi Global i Mjedisit (GEF), të cilët janë thelbësorë për financimin e projekteve të klimës dhe mbështetjes për zhvillim të qëndrueshëm.	Anëtarësimi në OKB do të mundësonte Kosovës që të përfshihej në diskutimet globale për klimën dhe ta shtronte çështjen e saj në nivel ndërkombëtar. Ky angazhim do të ndihmonte në forcimin e pozicionit të Kosovës për marrëdhënie të reja ndërkombëtare dhe mundësi investimesh në teknologjitë e gjelbra dhe projektet për klimën.

ÇFARË PO HUMBË KOSOVA?

Kosova, për shkak të mos anëtarësimit në OKB, nuk mund të marrë pjesë në shumë organizata ndërkombëtare, përfshirë Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC), që ofrojnë raporte shkencore dhe rekomandime për politikat globale të klimës. Ky kufizim e bën më të vështirë që Kosova të marrë pjesë dhe të ndikojë në negociatat ndërkombëtare të klimës.

Qasje në mekanizmat e rëndësishëm financiarë dhe mbështetje që janë të rezervuara për shtetet anëtare të KB-së, duke e bërë më të vështirë realizimin e projekteve për klimën dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Një pengesë tjetër e rëndësishme për Kosovën është mungesa e mundësisë për të përfituar në **Vlerësimin e Nevojave Pas Fatkeqësive (PDNA)**, që është një proces i udhëhequr nga OKB dhe Banka Botërore, që synon të ndihmojë shtetet për të vlerësuar dhe adresuar ndikimet e fatkeqësive natyrore. Kosova e ka përjetuar këtë pengesë në vitin 2022, pas përmytjeve masive që goditën qytete si Fushë Kosova, Vushtria dhe Vitia. Autoritetet e Kosovës kishin kërkuar mundësinë për të marrë pjesë në PDNA, por për shkak të mosanëtarësimit në OKB, ato nuk mund të përfitonin nga ky proces dhe të merrnin mbështetje ndërkombëtare për të vlerësuar dhe adresuar dëmet.

Mungesa e anëtarësimit në KB pengon Kosovën që të nënshkruajë disa marrëveshje ndërkombëtare dhe të angazhohet në bashkëpunim me shtete që kërkojnë anëtarësim në OKB për të zhvilluar marrëdhënie diplomatike dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë për klimën.

TABELA 2: Përfitimet dhe humbjet nga pranimi dhe mos pranimi në organizata ndërkombëtare

Në kohën e hartimit të këtij raporti, Kosova përfiton/humb nga këto organizata, mekanizma apo programe të BE-së:

ORGANIZATA/ MEKANIZMI/ PROGRAME	KOSOVA	SHTETE TJERA TË BALLKANIT PERËNDIMOR
UCPM	Jo anëtare	Anëtarë ³⁹
UN/UFCCC	Jo anëtare	Marrëveshje bashkëpunimi
TAIEX	Marrëveshje (IPA rajonale)	Marrëveshje (IPA rajonale)
TWINING	Marrëveshje (IPA vjetore dhe ajo rajonale)	Marrëveshje (IPA vjetore dhe ajo rajonale)
WB/EBRD/KfW/UNICEF/ UNDP	Marrëveshje bashkëpunim/IPA përfituese	Marrëveshje bashkëpunimi/IPA përfituese
Nisma e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SECI)	Vëzhguese ⁴⁰	Anëtarë

TABELA 3: Statusi i Republikës së Kosovës në organizatat dhe mekanizmat ndërkombëtar

39 Vendimi 1313/2013/BE i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 17 dhjetor 2013 për një Mekanizëm të Mbrojtjes Civile të Bashkimit, siç është ndryshuar, Gazeta Zyrtare L 347, 20 dhjetor 2013, fq. 924, i njohur më tej si "Vendimi UCPM". Mekanizmi përfshin 27 Shtetet Anëtare dhe 10 Shtete Pjesëmarrëse: Islanda, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Norvegjia, Serbia dhe Turqia; Shqipëria dhe Bosnja dhe Hercegovina iu bashkuan në vitin 2022; Republika e Moldavisë dhe Ukraina iu bashkuan në vitin 2023

40 Kosova nuk është anëtare e SECI-t, por ka pasur raste kur është përfaqësuar në mënyrë indirekte përmes UNMIK-ut, në mungesë të njohjes së saj të plotë si shtet nga të gjitha vendet e rajonit.

6. Institucionet për reagim ndaj katastrofave natyrore: Sfidat dhe nevojat

Në rast të përballjes me katastrofat natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri, institucionet dhe reaguesit e parë janë shërbimi shëndetësor, Policia e Kosovës dhe AME.

Në arkitekturën institucionale të Kosovës, institucione të ndryshme kanë mandat dhe përgjegjësi për t'u marrë me aspekte të ndryshme të ndërlidhura me klimën.

SEKTORI/FUSHA	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE
ZBATIMI HORIZONTAL (NDËRINSTITUCIONAL) PËR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT MJEDISOR	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave/Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale)
 AJRI	- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave/Divizioni për Mbrojtjen nga ndotja Industriale;) - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit/Instituti Hidrometeorologjik. INSTITUCIONE TJERA: - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministria e Shëndetësisë - Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal.



MBETURINAT

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Divizioni për kimikate dhe mbeturina)
- Komunat e Republikës së Kosovës.⁴¹
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit

INSTITUCIONET TJERA:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR)
- Ministria e Shëndetësisë (MSh)
- Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL)



UJËRAT

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujerave)
- Autoriteti Rajonal i Pëllgjeve Lumore
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit

INSTITUCIONET TJERA

- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal
- Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Kanalizim



NDRYSHIMET KLIMATIKE

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale)
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit
- Instituti Hidrometeorologjik

41 Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2012). Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat, Neni 13. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [...] Komunat sipas ligjit për mbeturina janë kompetente për menaxhimin e mbeturinave të ngurta, mbeturinat vëllimore, mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore...



MBROJTJA CIVILE

- Ministria e Punëve të Brendshme
- Agjencia për Menaxhimin e Emergjencës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit përkatësisht Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale)
- Instituti Hidrometeorologjik

INSTITUCIONET E TJERA QË KANË TË BËJNË ME FUSHËN MBROJTJES CIVILE JANË KRYESISHT

- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
- Njësia e zjarrfikësve të Kosovës
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal



PYJET

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (Departamenti i Pylltarisë)
- Agjencia Pyjore e Kosovës

INSTITUCIONET TJERA:

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal.

6.1 Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe kapacitetet e reagimit ndaj katastrofave Natyrore në Kosovë

AME është institucioni kryesor përgjegjës për menaxhimin e rasteve të katastrofave natyrore dhe situatave emergjente në Kosovë. Ajo operon brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe ka për mandat menaxhimin e katastrofave natyrore, pandemive dhe emergjencave të tjera të sigurisë publike. AME ka një staf prej rreth 720 punonjësish, përfshirë stafin administrativ, operativ dhe atë menaxhues, por ky numër konsiderohet i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat e vendit me mbi 1.5 milionë banorë. Rritja e staft do të mundësonte përmirësimin e cilësisë së punës dhe do të

ndihmonte vendin të përballlet më mirë me katastrofat natyrore.

Një nga problemet kryesore të Agjencisë është mungesa e burimeve njerëzore të specializuara. AME nuk ka ekipe të dedikuara për kërkim-shpëtim në zona urbane, malore ose në situata të tjera të specializuara, përveç një ekipe të vogël për shpëtim dhe evakuim në ujëra të cekëta. Po ashtu, pajisjet e saj janë të kufizuara, si dy pompa të fuqishme për nxjerrjen e ujit dhe disa varka të vogla. Pajisjet që ka AME janë testuar pak dhe kanë pasur probleme gjatë kërkesave për ndihmë, siç ndodhi me homologët maqedonas disa vite më parë.⁴² AME ka një kontigjent zjarrfikësish që operon në nivel lokal, por teknologjia dhe mekanizmat që përdoren janë të vjetëruara dhe nuk përmbushin standardet

⁴² Intervistë me zyrtarë nga AME, 11.12.2024

moderne të kërkuara për reagim të shpejtë dhe efikas ndaj fatkeqësive. Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit vjetor shkon për mirëmbajtjen e pajisjeve të vjetra, disa prej të cilave datojnë që nga vitet e 70'ta.⁴³

Një tjetër sfidë është mosha e shtyrë e punonjësve të AME-së, sidomos zjarrfikësve. Ky problem sfidon punën e AME-së, sidomos kur bëhet fjalë për ndërhyrjet në shuarjen e zjarreve ose menaxhimin e pasojave të reshjeve të shpeshta, vërshimeve dhe përmbytjeve. Procesi i rekrutimit të punonjësve të rinj dhe të trajnuar është i nevojshëm për rinovimin e këtij institucioni dhe forcimin e kapaciteteve për t'u përballur me sfidat në rritje.

Një problem tjetër është fragmentimi i strukturës operacionale. AME nuk ka kontroll të drejtpërdrejtë mbi zjarrfikësit, të cilët janë të shpërndarë në të gjitha komunat dhe menaxhohen nga drejtoritë komunale për mbrojtje dhe shpëtim. Edhe pse ky model është përdorur me sukses në vende të tjera, si Sllovenia dhe Kroacia, në Kosovë ky sistem ka dështuar për shkak të kapaciteteve të dobëta të nivelit lokal. Ky fragmentim shkakton vonesa dhe koordinim të paefektshëm në rastet emergjente. Një model më i centralizuar, i ngjashëm me atë të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, mund të mundësonte një reagim më të shpejtë dhe më efikas.

Për të adresuar këto probleme, duhet të përqendrohemi në forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të AME-së. Rregullimi i statusit juridik të zjarrfikësve dhe vendosja e tyre nën menaxhim të drejtpërdrejtë nga AME është një ndër hapat e parë. Rritja e numrit të zjarrfikësve, të cilët aktualisht janë në një moshë shumë të shtyer, është e domosdoshme dhe mund të realizohet përmes rekrutimit të 350-500 punonjësve të rinj. Përmirësimi i kushteve të punës për punonjësit e AME dhe zjarrfikësit është gjithashtu një prioritet, duke përfshirë blerjen e pajisjeve të reja për shuarjen e zjarreve dhe për kërkim-shpëtim në rast të fatkeqësive natyrore.

Një tjetër masë që duhet të ndërmarë MPB-ja dhe Qeveria e Kosovës është mbështetja për ndërtimin e njësive të specializuara për kërkim-shpëtim në rast të tërmeteve, përmbytjeve, kërkimit në male dhe zhytje, si dhe për vendosjen e barrierave për mbrojtjen e infrastrukturës. Këto njësitë mund të përballen me

katastrofat natyrore dhe mund të ndihmojnë për të përballuar ndikimin e ndryshimeve klimaterike.

Themelimi dhe operacionalizimi i Brigadës së Mbrojtjes Civile, në kuadër të AME, mund të rrisë qëndrueshmërinë e Kosovës ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave civile. Ofrimi i trajnimeve profesionale për kërkim-shpëtim dhe reagimin ndaj emergjencave civile është shumë i rëndësishëm për ta bërë këtë institucion më të përgatitur për të reaguar ndaj fatkeqësive natyrore dhe situatave emergjente. Operacionalizimi i AME-së me të gjitha njësitë e nevojshme dhe në përputhje me standardet e BE-së do të forconte kapacitetet vendore për të përballuar katastrofat natyrore dhe ato të tjera që mund të vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike.

6.2 Forca e Sigurisë e Kosovës dhe reagimi ndaj katastrofave natyrore

FSK është një nga institucionet më të përgatitura në vend për reagim në raste të katastrofave natyrore, veçanërisht për kërkim-shpëtimin. Pjesë e FSK-së është një njësi specializuar për kërkim-shpëtim urban, e cila ka realizuar intervenime të suksesshme gjatë tërmeteve shkatërruese në Shqipëri dhe Turqi. FSK-ja është e pajisur me pajisje moderne, përfshirë njësinë K9, e cila përdor qen të trajnuar për kërkim-shpëtim. Megjithatë, përkundër pajisjeve moderne, FSK ka ende nevojë për kapacitete dhe staf të shtuar për të përballuar sfidat që vazhdojnë të rriten, të shkaktuara nga ndryshimet klimatike.

FSK mbetet një nga institucionet më të rëndësishme për mbrojtjen e vendit, jo vetëm nga kërcënimet klasike të sigurisë kombëtare, por edhe nga ato që lidhen me katastrofat natyrore dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike. Aktualisht, FSK ka kapacitete për reagim ndaj katastrofave natyrore, kërkim-shpëtim, dhe ka pajisje të specializuara për këto operacione. Për të përballuar kërcënimet dhe rreziqet që vazhdojnë të rriten për shkak të ndryshimeve klimatike, FSK duhet të fokusojë përpjekjet për të rritur kapacitetet e saj reaguese ndaj katastrofave natyrore dhe atyre të tjera.

Një prioritet i rëndësishëm duhet të jetë rritja e kapaciteteve të njësive ajrore të FSK-së, të cilat do të jenë të dobishme për reagimin ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave të tjera. Aktualisht, Kosova mbështetet vetëm në mbështetje nga KFOR-i për

⁴³ Intervistë me zyrtarë nga MPB, 12.12.2024

mbështetje ajrore, duke përfshirë menaxhimin e zjarreve, ndërhyrje në rast të përmbytjeve, dhe nevojat e kërkim-shpëtimit. Kosova ka marrë mbështetje nga aleatët e NATO-s dhe SHBA për fillimin e procesit të blerjes së pajisjeve ajrore (helikopterë), të cilat do të përmirësojnë aftësinë e vendit për t'u përballur me kërcënimet dhe sfidat e sigurisë, duke përfshirë ato që janë pasojë e ndryshimeve klimatike.

Ministria e Mbrojtjes duhet të fillojë sa më shpejt procedurat për blerjen e pajisjeve ajrore dhe pajisjeve të tjera për mbështetje të përgjithshme, që të sigurojë përgatitjen e duhur të vendit për t'u përballur me katastrofat natyrore dhe emergjencat që mund të lindin.

6.3 Institucionet tjera

Policia e Kosovës, së bashku me AME dhe personeli i urgjencës mjekësore, është një nga reaguesit e parë në rastet e katastrofave natyrore. PK është institucioni i parë që informohet për çdo fatkeqësi që ndodh në vend dhe ofron ndihmë dhe intervenime të ndryshme, bazuar në kompetencat dhe mandatin e saj. Ajo siguron rend dhe siguri, duke ofruar edhe ndihmë logjistike dhe ndërhyrje, në varësi të kërkesave që vijnë nga institucionet tjera.

Ministria e Shëndetësisë (MSH), drejtoria komunale e shëndetësisë, ambulancat dhe spitalet rajonale, janë gjithashtu pjesë e grupit të reaguesve të parë në rastet e katastrofave natyrore dhe atyre të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. MSH ka në dispozicion gjashtë spitale rajonale dhe spitalin qendror në Prishtinë, si dhe një numër ambulancash dhe QKMF/AMF në fshatra, që mund të ofrojnë shërbime shëndetësore të ndryshme. Megjithatë, MSH ka kapacitete të kufizuara për të menaxhuar një fluks të madh pacientësh në rastet e fatkeqësive të mëdha, siç mund të jenë tërmetet ose rreziqet e tjera të mëdha.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) mbikëqyr zbatimin e Strategjisë së Zvogëlimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe zhvillon politika për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit, duke adresuar rrezatimin radioaktiv, ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, dhe monitorimin e

reshjeve dhe fatkeqësive hidrometeorologjike. Ajo siguron gjithashtu zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, rrugore dhe ajrore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve, duke përfshirë mbrojtjen dhe ripyllëzimin, parandalimin e zjarreve dhe mexnaxhimin e sëmundjeve dhe insekteve. Kjo ministri ka një rol të rëndësishëm në përballimin me pasojat e ndryshimeve klimatike, duke monitoruar dhe mbrojtur pyjet, të cilat janë të prekura nga dëmtimet dhe shkatërrimet, si pasojë e faktorëve të ndryshëm, përfshirë ndryshimet klimatike.

6.4 Niveli lokal

Komunat, si njësi të qeverisjes lokale, luajnë një rol kyç në hartimin e planeve për t'u përballur me kërcënimet dhe rreziqet që burojnë nga ndryshimet klimatike dhe faktorët e tjerë. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale u jep komunave kompetenca të gjera në fusha të ndryshme, veçanërisht në planifikimin hapësinor, zhvillimin ekonomik dhe menaxhimin e burimeve natyrore.⁴⁴

Megjithatë, një nga dështimet më të mëdha të komunave është paaftësia për të integruar masat kundër ndryshimeve klimatike në planet e tyre të zhvillimit apo planet urbanistike. Në shumë raste, komunat kanë kontribuar në përqendrimin e pasojave të ndryshimeve klimatike përmes planifikimit të dobët urban, shfrytëzimit të pakontrolluar të burimeve natyrore dhe menaxhimit të pamjaftueshëm të projekteve të ndërtimit, si dhe ndërtimit të dobët të infrastrukturës ujore dhe sistemeve të kanalizimit.

Urbanizimi i pakontrolluar dhe humbja e hapësirave të gjelbra janë probleme të theksuara në Kosovë. Komunat shpesh miratojnë plane urbane pa marrë parasysh ndikimin mjedisor, duke lejuar ndërtimin në sipërfaqe të gjelbra dhe hapësira publike. Kjo ka çuar në humbjen e hapësirave të gjelbra dhe sipërfaqeve të mbuluara me pemë, të cilat janë jetike për uljen e temperaturave urbane dhe thithjen e gazrave serrë.

⁴⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-043 për Mbrojtjen e Mjedisit. Marrë nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530>

Shumë komuna nuk arrijnë të zbatojnë standarde të qëndrueshme urbanistike dhe shpesh lejojnë ndërtime pa analiza të ndikimit mjedisor. Sipas raportit të KDI-së, shumë komuna nuk kanë implementuar asnjë masë për përmirësimin e gjendjes mjedisore, duke rrezikuar shëndetin e qytetarëve dhe ekosistemet lokale.⁴⁵

Komunat shpesh kanë probleme me menaxhimin e ujërave dhe uljen e rrezikut nga përmbytjet. Shumë komuna nuk kanë investuar në infrastrukturën e nevojshme për të përballuar reshjet ekstreme të shiut, të cilat janë intensifikuar si pasojë e ndryshimeve klimatike. Kanalizimet e vjetra dhe mungesa e zonave të gjelbra përthithëse kanë bërë që përmbytjet të bëhen më të shpeshta, duke dëmtuar infrastrukturën dhe pronat private. Një raport i Bankës Botërore thekson se rreth 60% e komunave në Kosovë kanë probleme serioze me përmbytjet, për shkak të mungesës së planifikimit të duhur hapësinor dhe menaxhimit të burimeve ujore.⁴⁶

Degradimi i tokës dhe humbja e burimeve natyrore është një tjetër problem që ndodh në territoret që komunat kanë përgjegjësinë e menaxhimit. Përdorimi i pakontrolluar i tokës për ndërtime dhe eksploatimi i mineraleve dhe burimeve natyrore nga bizneset private shpesh ndodh pa mbikëqyrjen e duhur nga komunat. Ky degradim i tokës kontribuon në zhdukjen e biodiversitetit dhe përkeqësimin e cilësisë së ajrit dhe ujit. Shumica e komunave në Kosovë nuk kanë plane të qarta për mbrojtjen e mjedisit, duke lejuar që kompanitë të shfrytëzojnë tokën pa masa rigjeneruese.⁴⁷

Menaxhimi i mbetjeve është gjithashtu një shqetësim alarmant. Shumë komuna në Kosovë kanë probleme serioze me menaxhimin e mbetjeve, duke çuar në ndotje të ujit, ajrit dhe tokës. Djegia e mbetjeve dhe depozitimi i tyre në vende të hapura ndikon drejtpërdrejt në ndotjen e ajrit dhe rrit nivelin e emetimeve të gazeve serrë. Kjo situatë përkeqëson cilësinë e jetesës dhe rrit rrezikun e sëmundjeve respiratore për banorët urbanë. Sipas raportit të UNDP-së për praktikatat e menaxhimit të mbetjeve, 80% e komunave nuk kanë sisteme të integruara të

menaxhimit të mbetjeve dhe mbështeten kryesisht në praktika të paqëndrueshme për largimin e tyre.

Në raport me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit (MSA), komunat përballen me një sërë sfidash. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) nuk bën monitorimin fizik të zyrtarëve për integrim evropian në nivel lokal, duke bërë që ata të mbeten të izoluar nga proceset vendimmarrëse. Për më tepër, këta zyrtarë nuk përfshihen në konsultime apo mbledhje të drejtorëve, duke reduktuar efektivitetin e tyre në zbatimin e politikave të integritit evropian.

Një tjetër problem është mungesa e trajnimeve në nivel lokal mbi mënyrën se si komunat mund të përfitojnë nga programet dhe instrumentet tjera financiare të Bashkimit Evropian. Shumë zyrtarë nuk janë të informuar mbi mundësitë për financime apo asistencë teknike, çka kufizon pjesëmarrjen e komunave në projekte zhvillimore të financuara nga BE-ja dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore. Zyrtarët për integrim evropian nuk përfshihen në takime me Departamentin e Integritimeve Evropiane dhe Koordinimit të Politikave (DIEKP) brenda ministrive të linjës apo me Zyrën Kombëtare Kordinuese të IPA-s (Zyra e NIPAC), duke e bërë të vështirë koordinimin dhe shkëmbimin e informatave mbi politikatat dhe mundësitë e përfitimit nga BE-ja.

Në nivel të bashkëpunimit ndër-komunal komunat nuk bashkëpunojnë sa duhet me njëra-tjetrën në çështje të rëndësishme si mbrojtja e pyjeve, ujërave dhe mjedisit në përgjithësi. Për më tepër, bashkëpunimi mes nivelit lokal dhe qendror gjithashtu mbetet i dobët. Raporti për Kosovën i vitit 2024 thekson se mungesa e koordinimit efektiv midis komunave dhe institucioneve qendrore ka ndikuar në implementimin e politikave. Këtu mund të konstatohet se ndikimi ka prekur negativisht edhe kordinimit për politika mjedisore dhe integritit evropian, duke kufizuar ndikimin e masave të ndërmarra për zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtje të mjedisit.

6.4.1 Kapacitetet e Komunave për parandalimin dhe reagimin ndaj katastrofave

Çdo komunë në Kosovë do duhej të kishte të themeluar drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim, e cila është përgjegjëse për vlerësimin e rreziqeve dhe

45 KDI. (2025). Fletënjoftimi mjedisor i komunave. Instituti Demokratik i Kosovës. Marrë nga <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2025/04/06-Raport-Fletenotimi-Mjedisor-i-Komunave-ALB-05-1.pdf>

46 Të dhëna të dala nga intervistat me zyrtarë komunal, Dhjetor 2024.

47 Të dhëna të dala nga intervistat me zyrtarë komunal, Dhjetor 2024.

kërcënimeve emergjente që i kanosen komunës dhe për përgatitjen për menaxhimin e tyre. Në rastet kur komunat nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të menaxhuar situata emergjente, ato kërkojnë ndihmë nga niveli rajonal dhe më pas ai qendror, kryesisht në AME.

Sipas legjislacionit në fuqi, komunat kanë mandat të hartojnë plane për mbrojtjen nga zjarret, mbrojtjen e pyjeve, reagimin emergjent dhe plane operative emergjente në nivel lokal. Këto dokumente janë thelbësore për reagimin ndaj katastrofave natyrore dhe ngjarjeve të tjera emergjente dhe duhet të aprovohen nga AME dhe MMPHI. Nga hulumtimi i realizuar mbi kapacitetet institucionale të komunave në menaxhimin e emergjencave, del qartë se ekziston një mungesë serioze e organizimit dhe vullnetit politik për të garantuar mbrojtjen civile të qëndrueshme. Sipas të dhënave, komuna e Prizrenit ka të themeluar Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës dhe ka miratuar Dokumentin e Vlerësimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, sipas kërkesave të Rregullores nr. 28/2012. Ndërkohë, Ferizaj dhe Suhareka, ndonëse kanë drejtoritë përkatëse për shërbime publike dhe emergjenca, nuk e kanë nxjerrë këtë dokument jetik, ndërsa Vitia nuk e ka as drejtorinë e themeluar e për rrjedhojë dokumentin e vlerësimit të rrezikut të miraturar, dhe Fushë Kosova nuk ka të themeluar një drejtori të tillë. Çdo komunë do duhej të kishte një drejtori funksionale për mbrojtje dhe shpëtim (apo të integruar brenda shërbimeve publike), si dhe të nixirte Dokumentin e Vlerësimit të Rrezikut dhe planin e veprimit për menaxhimin e fatkeqësive, ku do të alokoheshin mjetet dhe burimet, si dhe do të përcaktohej qartë koordinimi ndër-institucional në raste emergjente. Mungesa e këtyre dokumenteve jo vetëm që reflekton mungesën e gatishmërisë institucionale, por edhe e bën më të vështirë koordinimin dhe reagimin në situata krizash, duke ndikuar drejtpërdrejt në kohëzgjatjen dhe cilësinë e fazës së rikuperimit – siç theksohet edhe në Raportin për Vendin të BE-së për vitin 2024. Kjo tregon për një mungesë të njohurive profesionale dhe kapaciteteve të nevojshme për menaxhimin e emergjencave.

Në shumicën e rasteve, komunat kërkojnë ndihmë të menjëhershme nga niveli qendror për pajisje dhe ekspertizë në raste të përmbytjeve apo zjarreve. Ky realitet dëshmon se përgjegjësia për reagimin ndaj katastrofave natyrore mbetet kryesisht mbi nivelin

qendror, ndërsa forcimi i kapaciteteve lokale nuk është vendosur si prioritet nga komunat.

Përkundër mandatit për hartimin e dokumenteve dhe planeve lokale emergjente, shumë komuna nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të adresuar kërcënimet nga ndryshimet klimatike dhe katastrofat natyrore. Komunat duhet të fillojnë hartimin e dokumenteve të vlerësimit të rreziqeve dhe të parashikojnë hapat konkret për adresimin e tyre, duke u koordinuar ngushtë me nivelin qendror dhe duke respektuar strategjinë shtetërore për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Zbatimi efikas i rolit mbikëqytës të organeve komunale, si drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim, është thelbësore për sigurinë dhe menaxhimin efikas të rreziqeve nga ndryshimet klimatike dhe katastrofat natyrore. Kjo kërkon një angazhim të fortë për të siguruar që sektori i ndërtimit të zbatojë standardet e duhura për ndërtimin dhe mbrojtjen mjedisore, duke u përpjekur për mbrojtjen e hapësirave të gjelbra dhe infrastrukturës që do të ndihmojë në përballimin e rreziqeve.

6.5 Bashkëpunimi me shoqërinë civile, komunitetin dhe grupet joformale të vullnetarëve

Bashkëpunimi ndërmjet komunitetit, institucioneve qendrore dhe lokale, si dhe sektorit privat, është esencial për të reaguar dhe përballuar pasojat e rreziqeve dhe kërcënimeve që vijnë si rezultat i ndryshimeve klimatike. Krijimi i grupeve vullnetarë në çdo komunë, të cilët mund të ndihmojnë autoritetet shtetërore në raste katastrofash natyrore dhe emergjencash të tjera, është një ndihmesë e madhe dhe e qëndrueshme për autoritetet shtetërore dhe lokale për të përballuar rreziqet që mund t'i kanosen shtetit. Autoritetet lokale, në bashkëpunim me MPB dhe agjencitë e saj (AME dhe Akademinë e Kosovës për Siguri Publike), mund të organizojnë trajnime bazike dhe të avancuara për vullnetarët, për t'u përballur me sfida të tilla si shuarja e zjarreve, reagimi në rast të përmbytjeve apo vërshimeve. Krijimi i grupeve vullnetarë në çdo komunë mund të shërbejë për forcimin e qëndrueshmërisë kombëtare, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, për të përballuar rreziqet dhe pasojat që vijnë si rezultat i ndryshimit të klimës apo ngrohjes globale.

Formalizimi dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet nivelit lokal dhe sektorit privat gjithashtu është esencial për të përballuar këtë fenomen. Një organizim i mirëfilltë i këtij bashkëpunimi dhe pajisja me informacion për sektorin privat lidhur me rolin që kanë kompanitë në sektorë të ndryshëm (ndërtim, transport, ushqim dhe supermarketet, mirëmbajtja e rrugëve, etj.) mund të ndihmojë në përballimin e rreziqeve dhe kërcënimeve që vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike. Sektori privat ka kapacitete njerëzore dhe teknike të shumta që mund të përdoren për punë në sektorë të ndryshëm si ndërtim, transport, mirëmbajtje rrugësh etj., pajisje të cilat lehtësisht mund të përdoren për të ndihmuar autoritetet shtetërore gjatë përballjes me rreziqe të tilla si zjarret, përmbytjet dhe vërshimet.

Pra, autoritetet lokale duhet të fillojnë me krijimin e trupave lokale, të përbëra nga komuniteti dhe sektori privat, të cilat mund të jenë të gatshme të reagojnë në raste emergjente.

Forcimi i bashkëpunimit me institucionet publike si ndërmarrjet rajonale për menaxhimin e burimeve ujore, për mbledhjen dhe menaxhimin e mbeturinave, për menaxhimin dhe trajtimin e ujrave të zeza, si dhe me institucionet qendrore dhe lokale për ruajtjen e parqeve dhe tokave pyjore, mbetet thelbësor për krijimin e një ambienti më të sigurt dhe më të qëndrueshëm ndaj proceseve të ndryshimeve klimatike dhe pasojave të këtij procesi.

Rekomandimet



- 1. Mbikqyrje më efikase të zbatimit të strategjive** përmes monitorimit të nivelit të arritshmërisë së objektivave dhe caqeve të vendosura në planet afatmesme të veprimit në raport me masat për klimën. Monitorimi duhet të përmbledhet në një proces ku edhe ministritë përgjegjëse për monitorim por edhe OSHC-të të profilizuara krahas fushë-mbulueshmërisë së strategjive. Për këtë të fundit kërkohet mbështetje më e strukturuar për OSHC-të e identifikuar që paralel monitorimit nga institucionet të bëhet edhe monitorim objektiv i jashtëm.
- 2. Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve të sigurisë,** përfshirë Policinë e Kosovës, Forcën e Sigurisë dhe Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave për të reaguuar ndaj emergjencave natyrore të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Ky proces duhet të përfshijë trajnime të avancuara për personelin, si dhe përmirësimin e sistemeve të komunikimit dhe koordinimit ndër-institucional për të mundur reagime më të shpejta dhe efikase në raste katastrofash natyrore si përmbytjet, zjarret dhe stuhi të tjera. Avansimi i misionit të AME-së si institucion me kapacitete reaguase në të gjitha profilet e kërkuara (përveqse misionit aktualisht e kryesisht koordinues) duhet të bëhet sa më parë në përputhje me standardet e BE-së. Përveq misionit, AME-ja duhet të përfshijë në organogramin e sajë ekipe të specializuara dhe të fillojë përgatitjen për operacione të kërkim-shpëtimit nga ajri. Paisja me helikopterë dhe paisje tjera operacionale ajrore është më se e nevojshme.
- 3. Renovimi i infrastrukturës për reagim emergjent** për përballimin efikas të emergjencave natyrore kërkon investime në renovimin e infrastrukturës për reagim emergjent. Kjo përfshin renovimin e flotës së automjeteve të emergjencës, si dhe përmirësimin e pajisjeve për trajtimin e zjarreve dhe përmbytjeve. Përveç kësaj, duhet të bëhen investime në përmirësimin e infrastrukturës për furnizimin me ujë dhe energji, që do të sigurojë mbështetje në situata të vështira emergjente dhe do të lehtësojë operacionet e shpëtimit.
- 4. Përgatitja e planeve komunale emergjente duhet të respektohet. Në rastet e mos-përgatitjes së këtij dokumenti, rekomandohet që AME të vijojë me procedurat e ndëshkimit.** Çdo komunë duhet të hartojë plane të detajuara emergjente për t'u përballur me sfidat e ndryshimeve klimatike dhe katastrofave natyrore. Ky proces duhet të përfshijë identifikimin e rreziqeve specifike për secilën zonë dhe zhvillimin e protokolleve për menaxhimin e situatave të mundshme. Plani duhet të bazohet në analiza të thelluara të burimeve dhe mundësive, duke përfshirë bashkëpunimin mes autoriteteve lokale dhe atyre qendrore për të siguruar reagim të shpejtë dhe të koordinuar.
- 5. Përfshirja e sektorit privat dhe OJQ-ve:** Përballja me emergjencat klimatike kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që përfshien sektorin privat dhe organizatat jo-qeveritare. Sektori privat mund të ndihmojë me zhvillimin e teknologjive inovative për parashikimin dhe monitorimin e katastrofave natyrore, ndërsa OJQ-të mund të kontribuojnë me edukim dhe sensibilizim të komunitetit për pasojat e ndryshimeve klimatike dhe masat që mund të merren për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.
- 6.** Për një menaxhim të suksesshëm të emergjencave, është thelbësore që komuniteti të aktivizohet dhe të jetë i përgatitur për t'u përballur me pasojat e ndryshimeve klimatike. Komunitetet duhet të edukohen për mënyrat e parandalimit dhe reagimin ndaj katastrofave natyrore. Krijimi i grupeve të shpejta reagimi në nivel lokal mund të sigurojë mbrojtjen e jetës dhe pasurisë së qytetarëve gjatë emergjencave.
- 7. Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar:** Përballë kërcënimeve të përbashkëta nga ndryshimet klimatike, është e rëndësishme që Kosova të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar. Kjo mund të realizohet

përmes pjesëmarrjes në marrëveshje dhe iniciativat ndërkombëtare për menaxhimin e emergjencave natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit. Bashkëpunimi me shtetet e tjera mund të sjellë përfitime të mëdha duke ndihmuar në ndarjen e burimeve dhe ekspertizës, si dhe në krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm reagimi ndaj katastrofave.

- 8. Menaxhimi i burimeve natyrore:** Për të zvogëluar ndikimet e katastrofave natyrore, është e domosdoshme të investohet në menaxhimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Kjo përfshin mbrojtjen e pyjeve, ujërave dhe biodiversitetit, si dhe zhvillimin e politikave që parandalojnë deforestimin dhe ndotjen. Mbrojtja e burimeve natyrore do të ndihmojë në forcimin e qëndrueshmërisë së Kosovës ndaj sfidave të ndryshimeve klimatike.
- 9. Politikat e ndërtimit dhe planifikimi urban:** Për të përballuar pasojat e ndryshimeve klimatike, është thelbësore që ndërtimi i ndërtesave dhe zhvillimi urban të jetë i qëndrueshëm. Politikat e ndërtimit duhet të përfshijnë standarde të larta sigurie dhe qëndrueshmërie, si dhe përdorimin e materialeve dhe teknologjive që reduktojnë ndikimet mjedisore. Po ashtu, planifikimi urban duhet të marrë parasysh

mundësitë për menaxhimin e ujërave dhe mbrojtjen nga përmytjet.

- 10. Përmirësimi i infrastrukturës për trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e ujit:** Përballimi i përmytjeve dhe vërshimeve kërkon investime në përmirësimin e sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza dhe ndërtimin e infrastrukturës për menaxhimin e ujërave të shiut (sistemi i ujërave atmosferik). Përveç renovimit të infrastrukturës ekzistuese, duhet të vendosen kritere strikte për ndërtimet e reja, veçanërisht në zonat urbane që janë të ndjeshme ndaj përmytjeve.
- 11. Rritja e kapaciteteve për menaxhimin e zjarreve:** Në një periudhë me ndryshime klimatike, është e domosdoshme që Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe institucionet vendore të forcojnë kapacitetet e tyre për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve. Kjo mund të realizohet përmes trajnimeve të vazhdueshme, investimeve në pajisje moderne dhe krijimit të planeve të koordinuara për trajtimin e zjarreve, veçanërisht në rajonet malore dhe fushore të Kosovës.

Annex 1.



FUSHAT KRYESORE	PROBLEMET AKTUALE	REKOMANDIMET PËR KOMUNAT
1. INTEGRIMI I PËRSHTATJES DHE PITIGIMIT TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË PLANIFIKIMIN URBAN	Planet Zhvillimore të Komunave (PZHK) dhe Planet e Rregullimit Urban (PRU) nuk përmbajnë masa të forta për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.	• Të kërkohet infrastruktura e gjelbër në rregulloret e zonimit (p.sh., trotuare të kalueshme, pyje urbane, menaxhimi i ujërave atmosferik). • Të zbatohet kërkesa për efikasitetin energjetik në lejet e ndërtimit. • Të implementohen dizajne të qëndrueshme ndaj nxehtësisë në hapësirat publike (p.sh., çati të gjelbërta, zona hije, materiale reflektuese). • Të zbatohet strikt plani i ndërtimit sipas lejes së dhënë dhe të ketë inspektime të rregulta
2. MENAXHIMI MË I MIRË I MBETURINAVE DHE POLITIKAT E EKONOMISË CIRKULARE	Shumë komuna nuk e zbatojnë ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave.	• Të krijohen dhe të zbatohet ndarja e detyrueshme e mbeturinave në nivelin e familjeve dhe bizneseve. • Të promovohen kompostimi dhe prodhimi i biogazit si pjesë e strategjive të menaxhimit të mbeturinave. • Të zhvillohen partneritete me kompani private dhe donatorë për investime në projekte të energjisë nga mbeturinat.
3. INICIATIVA PËR ENERGI TË RINOVUESHME DHE EFIKASITET ENERGETIK T	Komunitat nuk kanë strategji lokale për energjinë rinovueshme, megjithëse Ligji për Energinë në Kosovë lejon planifikimin në nivel komunal.	• Të mbështeten panelet diellore në ndërtesat komunale dhe të promovohen projekte diellore komunitare. • Të zhvillohen programe për efikasitet energjetik në ndërtesat publike (shkolla, spitale, zyra administrative). • Të krijohen stimuj financiarë në nivel komunal për bizneset dhe familjet për të miratuar teknologji energjetike efikase.

4.	MENAXHIMI I UJIT NË KUSHTET E QËNDRUESHMËRISË KLIMATIKE	Humbjet e ujit në Kosovë kalojnë 50% për shkak të infrastrukturës të vjetruar.	• Në bashkëpunim me Hidrosistemet rajonale, të modernizohet sistemi i shpërndarjes së ujit për të zvogëluar rrjedhjet dhe humbjet. • Të krijohen politika për mbledhjen dhe ripërdorimin e ujërave të shiut. • Të implementohen sisteme të qëndrueshme të ujit për zonat bujqësore.
5.	TRANSPORTI I QËNDRUESHËM (PLANET E MOBILITETIT) DHE MENAXHIMI I CILËSISË SË AJRIT	Investimet në transportin publik janë minimale dhe mungon infrastruktura për transportin jo-motorik.	• Të zgjerohet rrjeti i transportit publik me autobusa me emisione të ulëta. • Të zhvillohen rrugë bicikletash dhe zona miqësore për këmbësorët për të zvogëluar varësinë nga makinat. • Të krijohen zona me emisione të ulëta në qendrat urbane për të kontrolluar ndotjen.
6.	ZHVILLIMI I PLANIFIKIMIT TË PËRSHTATSHMËRISË KLIMATIKE DHE MENAXHIMI I RREZIKUT TË DËSHTIMEVE (DRR)	Pothuajse asnjë komunë nuk ka plane të qëndrueshmërisë klimatike funksionale.	• Të kryhen vlerësime të rrezikut klimatik dhe të integrohen ato në planet e veprimtimit komunal. • Të forcohen sistemet e paralajmërimit të hershëm për përmytjet, thatësiat dhe ngjarjet ekstreme të motit. • Të trajnohen zyrtarët lokalë dhe shërbimet e emergjencës për përgatitjen ndaj katastrofave të lidhura me klimën.
7.	FORCIMI I PJESËMARRJES PUBLIKE DHE NDËRGJEGJËSIMI	Ka një mungesë të angazhimit të qytetarëve në proceset vendimmarrëse të lidhura me klimën.	• Të organizohen forumet publike për veprimet klimatike për të rritur ndërgjegjësimin. • Të inkurajohen të rinjtë dhe organizatat e shoqërisë civile të marrin pjesë në këshillat klimatike komunale. • Të ofrohen stimuj për bizneset e gjelbra dhe nismat miqësore me klimën në nivel lokal.

8. MUNGESA E LOORDINIMIT KOMUNË-QEVERI	Koordinimi i dobët midis institucioneve komunale dhe atyre qendrore vonon veprimet për klimën.	• Të krijohen kanale më të mira komunikimi midis qeverive lokale dhe kombëtare. • Të harmonizohen politikat komunale të klimës me strategjitë kombëtare. • Të rritet mbështetja financiare dhe teknike për komunat nga institucionet qendrore.
9. MUNGESA E MONITORIMIT DHE LLOGARIDHËNIES	Mbledhja e të dhënave është e kufizuar dhe zbatimi i politikave për klimën është i dobët.	• Të zhvillohen sisteme komunale për monitorimin dhe raportimin mbi klimën. • Të rritet fondi aktual dhe kriteret për grantet e performancës komunale. Kritiere që bazohen në performancën për komunat që arrijnë objektivat e klimës është e domosdoshme. • Të rritet transparenca përmes raporteve publike mbi përparimin e veprimeve klimatike.

Pikat e shprehura dhe opinionet janë ato të autorit/autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur - Ballkani Perëndimor.

Autorë:

Skender Perteshi

Andi Batusha

Dizajnuar nga:

Brand Vision Shpk

Kontakti: +383 45 559 923

Email: brandvision.rks@gmail.com

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen sipas Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme, mjeti elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen e shkruar të botuesit. Shfrytëzimi komercial i materialeve të botuara nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT nuk lejohet pa lejen e shkruar.

Prishtinë, Mars 2025



PREVENT

INSTITUTI PËR SIGURI DHE REZILIENCË

